

THE KOSOVO BANKER

QERSHOR 2022
EDICIONI 20

Presionet Globale Inflacioniste: Ndikimet në Kosovë dhe Rajon

20
YEARS

Kosovo Banking Association
Shoqata e Bankave të Kosovës



**Menaxhimi i
pasurisë në periudha
inflacioniste**

**Inflacioni dhe efektet
e tij tek bizneset e
vogla dhe të mesme**

**Instrumentet financiare
për ta parandaluar,
kontrolluar dhe vonuar
ndikimin e inflacionit**



Mundëson Digjitalizimin
e Pagesave.



Vetëm Klike

Kontakt: paylink.al/ info@paylink.al



THE
KOSOVO
BANKER

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS
SË BANKAVE TË KOSOVËS



ALBERT LUMEZI
NLB Bank / Kryetar i Bordit të SHBK



SUAT BAKKAL
Banka Kombëtare Tregtare / Zv. Kryetar i Bordit të SHBK



PETRIT BALIJA
Shoqata e Bankave të Kosovës



ANITA KOVACIC
Raiffeisen Bank



ARTON CELINA
Banka për Biznes



ERIOLA BIBOLLI
ProCredit Bank Kosova



MERITON SUNDURI
Ziraat Bank



OGUZHAN CEYLAN
IS Bank



ORCUN OZDEMIR
TEB Bank



SELMAN LAMAJ
Credins Bank



SHPEND LUZHA
Banka Ekonomike

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) mbështet zhvillimin e sektorit bankar dhe është zëri përfaqësues i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. Ne mbështesim bankat anëtare për të arritur objektivat e tyre duke ofruar një platformë për avokim, ngritje kapacitetesh dhe marrëdhënie me publikun. Banka është kyçe për zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik të Kosovës dhe ne ndihmojmë në avancimin e kësaj kauze. Objektivat tona kryesore janë krijimi i kushteve optimale për një sektor bankar inovativ, të qëndrueshëm, të sigurt dhe gjithëpërfshirës në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës, 177, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

PËRMBAJTJA

06 PARATHËNIE

PETRIT BALIJA - Kryeshef Ekzekutiv -
Shoqata e Bankave të Kosovës

08 OPINION

MASSIMILIANO PAOLUCCI - Menaxher i
Bankës Botërore për Kosovën & **ISOLINA ROSSI**,
Ekonomiste Banka Botërore
**PRESIONET GLOBALE INFLACIONARE:
NDIKIMI NË KOSOVË DHE RAJON**

12 SEKTORI FINANCIAR

GEM MALOKU - Anëtar i Bordit Menaxhues - NLB
Bank - **Ndikimet e inflacionit në ekonominë reale**



16 ANITA KOSUMI-AJETI

Udhëheqëse e Departamentit të Burimeve
Njerëzore - Banka për Biznes
**Zhvillimi i kapitalit njerëzor, trajnimet dhe Akademia
e Burimeve Njerëzore**

18 ANA GOGA

Drejtoresh e Divizionit Financiar,
CFO - CREDINS Bank Kosova,
**Rritja e inflacionit do të vazhdojë të përforcojë
pabarazinë, si brenda dhe ndërmjet vendeve**

20 ARIJAN HAXHIBEQIRI

ZV/Kryeshef Ekzekutiv -
Banka Ekonomike, **Efektet zingjire si rezultat i
presioneve globale inflacioniste**

24 FISNIK LATIFI

Menaxher i të ardhurave fikse -
Raiffeisen Bank Kosovë
Menaxhimi i pasurisë në periudha inflacioniste

27 ARGJIRA KADRIJAJ DUSHI

Udhëheqëse për
zhvillim biznesi - ProCredit Bank Kosovë - **Inflacioni
dhe efektet e tij tek bizneset e vogla dhe të mesme**

29 BUJAR STATOVCI

Udhëheqës i Departamentit të
Biznesit - Banka për Biznes
Efektet e Inflacionit në ekonominë e Kosovës



31 BURSA STUDENTORE "THE KOSOVO BANKER"

33 GENTIANA HALIMI

Departamenti për Institucione
Financiare - Banka Kombëtare Tregtare Kosovë,
Faktorët global që kontribuan në rritjen e çmimeve

34 ALBERT DEVAJA

Specialist i Kontrollit të Riskut -
Raiffeisen Bank Kosovë
Inflacioni si parakusht i deflacionit sekular

KËNDI I EKSPERTËVE

36 ENEIDA THOMAJ

Drejtoresh e Përgjithshme -
PayLink Albania,
**Disa nga strategjitë që mund të ndiqen në fushën
e pagesave nën ndikimet inflacioniste!**

38 BANKAT FUQIZOJNË SHOQËRINË

17%

e portfolios së
përgjithshme të kredive
në Bankën ProCredit Kosova
janë **kredi të gjelbra**



Raporti i Ndikimit të Grupit ProCredit për vitin 2021

Informacione të detajuara rreth
qasjes sonë ndaj qëndrueshmërisë,
ndikimit dhe kontributit në Objektivat
e Zhvillimit të Qëndrueshëm



PETRIT BALIJA
KRYESHEF EKZEKUTIV
SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Presionet globale inflacioniste : Ndikimet në Kosovë dhe rajon

Nobelisti i shkencave ekonomike Milton Friedman kishte thënë se “Inflacioni është tatim pa legjislacion”. Kjo është një thënie që mendoj se e përshkruan më së miri ndikimin e inflacionit në mirëqenien financiare të gjithsecilit, qoftë individë apo biznes.

Kosova po përballet me kriza të njëpasnjëshme në tre vitet e fundit, që nga goditja e vendit nga pandemia kur i gjithë sistemi ekonomik pësoi një luhajtje tektonike e cila ishte e ndërthurur me problemet shëndetësore dhe të sigurisë së furnizimit me ushqime dhe produkte, duke vazhduar më pastaj me krizën energjetike të rritjes së çmimeve të energjisë elektrike dhe deri te presionet enorme inflacioniste që kemi parë së fundi.

Një aspekt ngushëllues për këtë valë të goditjeve konsektive është të kuptuarit se këto kriza Kosova po i ndan jo vetëm me rajonin por me gjithë botën pasi që janë kriza të nivelit global dhe se të gjithë jemi një në luftën kundër këtyre zhvillimeve negative. Megjithatë, ndikimi mbi vendet në zhvillim si Kosova janë shumë herë më të larta se në vendet të cilat janë ekonomikisht të konsoliduara mirë

**EKONOMIA E VENDIT TONË
GJATË VITIT 2021 SHËNOI
NDËR RRRITJEN MË TË MADHE
QË KA NDODHË NË DY
DEKADAT E FUNDIT PREJ MBI**

10%

**SIGURISHT NJË EFEKT I
PRITSHËM PAS TKURRJES
QË KISHTE NDODHUR
NË VITIN 2020 PREJ**

5.3%

**NË KOHËN KULMORE TË
PERIUDHËS SË PANDEMISË,
PËRDERISA VLERËSIMET PËR
VITIN 2022 JANË QË KOSOVA
DO TË SHËNOJË RRRITJE
TË BRUTO PRODHIMIT
VENDOR PREJ RRETH**

4%

dhe me mundësi të intervenimeve shtetërore për të zbutur krizën dhe për të kontrolluar inflacionin. Kosova është më e cenueshme krahasi këtyre krizave, pasi që, kapacitetet për t'i absorbuar këto kriza janë të limituara dhe varshmëria ekonomike nga importi është shumë e lartë.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës është duke dërguar sinjale jo të mira nëpër gjithë botën, përfshirë edhe rajonin tonë, duke acaruar rritjen e çmimeve të energjisë, dhe që për pasojë ka edhe rritjen e çmimeve të ndërtimit dhe të ushqimit, por gjithashtu duke shkaktuar edhe trazira në tregje dhe në rrjedhën e investimeve, duke e sjellë rajonin si dhe vendin tonë në një situatë më të vështirë të ringjalljes post-pandemike.

Ekonomia e vendit tonë gjatë vitit 2021 shënoi ndër rritjen më të madhe që ka ndodhë në dy dekadat e fundit prej mbi 10%, sigurisht një efekt i pritshëm pas tkurrjes që kishte ndodhur në vitin 2020 prej -5.3% në kohën kulmore të periudhës së pandemisë, përderisa vlerësimet për vitin 2022 janë që Kosova do të shënojë rritje të bruto prodhimit vendor prej

“

*Nobelisti i shkencave ekonomike
Milton Friedman kishte thënë se
“Inflacioni është tatim pa legjislacion”.*

”

rreth 4%. Krahas rritjes ekonomike në vend gjatë 2021, inflacioni në vitin 2021 në Kosovë shënoi vlerën prej 3.4%, ndërsa inflacioni në fund të muajit prill të vitit 2022 në Kosovë shënoi vlerën prej 11.2%.

Pra, kjo ka dëshmuar edhe një herë se asnjë vend sado i vogël apo me shkallë të ulët të integritimit në ekonominë ndërkombëtare nuk është immune ndaj zhvillimeve të rëndësishme globale dhe se ato ndikojnë në formë zinxhirore në ekonominë e secilit vend të botës, duke përfshirë me këtë rast edhe Kosovën dhe vendet e rajonit.

Për qytetarin e rëndomtë inflacioni ka disa implikime negative duke filluar nga varfërimi i shportës së konsumit, humbja e fuqisë blerëse të kursimeve, rritja e çmimit të pronave për banim, si dhe për ata që kanë investime në aksione në bursat ndërkombëtare rënie e vlerës së aksioneve në masë të konsiderueshme (nëse flasim në mesatare të indekseve të tregjeve globale). Të gjithë këta faktorë bëjnë që inflacioni të konstatohet si armiku më i madh dhe më i rrezikshëm i mirëqenies financiare të gjithsecilit. Kjo situatë më së miri e shpjegon edhe arsyen pse rregullatorët financiar si Banka Qendrore Evropiane kanë si mandat kryesor kontrollimin e inflacionit brenda parametrave të caktuar.

Në gjithë këtë situatë të pasigurisë ekonomike dhe politike globale, sektori bankar i Kosovës vazhdon të punojë fuqishëm për të garantuar një stabilitet të qëndrueshëm financiar dhe kreditim sa më të qasshëm për qytetarët dhe bizneset

e vendit. Indikatorët e performancës së sektorit bankar në Kosovë tregojnë se sektori është mirë i kapitalizuar, likuid dhe profitabil. Kjo performancë i mundëson bankave që të injektojnë kapitalin e nevojshëm për ekonominë e vendit për të mundësuar që ekonomitë familjare dhe bizneset të tejkalojnë këto kriza duke qenë të sigurtë që tregjet dhe inflacioni do të stabilizohet me kalimin e kohës, edhe pse kohëzgjatja e këtyre efekteve nuk mund të parashikohet.

Deri në mars të vitit 2022 sektori bankar ka aprovuar kredi të reja në vlerë prej 508 milion euro e që tejkalon nivelin e kreditimit të viteve paraprake. Megjithatë, ka një ngadalësim në rritjen e depozitave të reja në krahasim me vitet paraprake, gjë që pritet të rrisë koston e fondeve për institucionet bankare e që mund të shkaktojë presione drejt rritjes së normave mesatare të interesit për kreditim. Për të minimizuar këto efekte kërkohet që institucionet kredituese të gjejnë burime alternative të fondeve siç mund të jetë zhvillimi i tregut të kapitalit, specifikuatij të obligacioneve të korporatave dhe obligacioneve bankare. Për të shtyrë tutje këtë zhvillim kërkohet bashkëpunimi i të gjitha palëve relevant përfshirë edhe rregullatorin e sektorit bankar, ministrinë përkatëse, organizatat ndërkombëtare zhvillimore dhe vetë akterët e sektorit privat.

Kosova dhe rajoni duhet të ndërtojnë mekanizma që garantojnë qëndrueshmëri financiare, fiskale dhe ekonomike në mënyrë që të përgatiten për krizat tjera

që mund të shfaqen në të ardhmen siç janë edhe paralajmërimet për krizat që mund të shkaktohen nga faktorët ambiental apo klimatik nga emetimi i karbonit, degradimi i pyjeve dhe biodiversitetit dhe ngrohjes globale. Shumë sfida pritet të rezultojnë nga këta faktorë, andaj edhe sektori bankar në Kosovë ka reaguar me një largpamësi të mirë duke u angazhuar pa vonësë rreth përmbljes së kriterëve ESG apo Ambiental, Social dhe Qeverisës të parashikuara me konventat e Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjes së Parisit. Shoqata e Bankave të Kosovës ka ndërmarrë disa hapa strategjikë për të avancuar sektorin në këtë drejtim duke u anëtarësuar në prill të këtij viti në Rrjetin për Bankim dhe Financim të Qëndrueshëm - SBFN i cili është një rrejt global i vendeve në zhvillim. Ky anëtarësim është një shprehje e vullnetit dhe përkushtimit të sektorit bankar në Kosovë drejt përmbljes vullnetare dhe sigurisht graduale të kriterëve ESG.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se sektori bankar në Kosovë vepron në mënyrë simbiotike me klientët e bankave dhe ekonominë e vendit për të krijuar një ekosistem financiar ku të gjithë do të përfitojnë, prandaj është me rëndësi që të ketë edhe mbështetjen e duhur nga institucionet dhe partnerët për të arritur objektivat të cilat do të shërbejnë që të tejkalojmë këto sfida ekonomike dhe të zhvillojmë vendin më tutje drejt një modeli më të qëndrueshëm ekonomik.



MASSIMILIANO PAOLUCCI
MENAXHER I BANKËS BOTËRORE PËR KOSOVËN



ISOLINA ROSSI
EKONOMISTE BANKA BOTËRORE

Presionet globale inflacionare: ndikimi në Kosovë dhe rajon

Kohëve të fundit, rajoni i Ballkanit Perëndimor gjendet në një realitet të ri ekonomik, ku presionet e larta inflacionare kërcënojnë përfitimet e rimëkëmbjes pas pandemisë. Kur shikojmë dinamikën e fundit të çmimeve, inflacioni është në rritje për shkak të një kombinimi faktorësh: rritja më e fortë globale që nga mesi i vitit 2020 ka vendosur presion në rritje mbi çmimet e mallrave bazë dhe kostot e transportit, duke ndikuar me inflacion më të lartë të importuar në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Paralelisht, forcimi i kërkesës së brendshme në vitin 2021 solli presion të mëtejshëm mbi çmimet. Inflacioni bazë në rajon arriti një nivel rekord prej 2.9 për qind në dhjetor 2021, me tronditje të vazhdueshme nga ana e ofertës

[zinxhirëve të furnizimit] dhe nga rritja e pagave që nxisin pritjet inflacionare. Tutje, pushtimi rus i Ukrainës i ka shtuar edhe më tutje presionet ndaj këtyre trendeve rritëse të inflacionit. Rritja e fundit e inflacionit në Ballkanin Perëndimor pasqyron një trend të ngjashëm me tregjet ndërkombëtare globale. Në nivel global, inflacioni arriti në 4.6 për qind në shkurt 2022¹, nga niveli më i ulët prej 1.2 për qind i ndikuar nga pandemia në maj 2020, duke reflektuar një kombinim të kufizimeve të ofertës dhe rritjes së vazhdueshme të kërkesës. Çmimet globale të ushqimeve u rritën për 29.3 për qind (nga viti në vit) gjatë vitit 2021², duke vendosur barrën më të rëndë mbi popullatën më të rrezikuar dhe

duke rritur turbulencat që minojnë rimëkëmbjen ekonomike globale. Rritja e çmimeve të ushqimeve goditi veçanërisht vendet me të hyra më të ulëta, ku ushqimi zë një pjesë shumë më të madhe të shportës së konsumit mesatar të familjeve. Përveç rritjes së çmimeve të ushqimeve, çmimet e mallrave bazë u rritën ndjeshëm që nga fillimi i vitit 2022. Për shembull, çmimet e energjisë³ ishin më shumë se katër herë më të larta në mars 2022 sesa nivelet më të ulëta të prillit 2020 – rritja më e madhe 23 mujore e çmimeve të energjisë që nga rritja e çmimit të naftës në vitin 1973. Çmimet më të larta të energjisë po ndikojnë në rritje të kostove të prodhimit dhe transportit, duke rritur nivelet e përgjithshme të çmimeve.

¹ Perspektivat Ekonomike Globale sipas Bankës Botërore, prill 2022
² Perspektivat Ekonomike Globale sipas Bankës Botërore, 2022
³ Në dollarë amerikanë

EVROPA

IMPORTON NJË PJESË TË KONSIDERUESHME TË ENERGJISË SË SAJ NGA RUSIA, DUKE PËRFSHIRË GAZIN NATYROR

35%

NAFTËN BRUTO

20%

DHE QYMYRIN

40%

TEKSA FURNIZIMI ME NAFTË DHE GAZ NGA RUSIA MUND TË VAZHDOJË NË MJEDISIN AKTUAL TË DOMINUAR NGA SANKSIONET, KA RISQE PËR NDËRPRERJE TË RËNDËSISHME NË RRUGËT KRYESORE TË TRANZITIT TË GAZIT DHE TRANSAKSIONET FINANCIARE TË LIDHURA ME ENERGINË.

Pushtimi rus i Ukrainës në shkurt 2022 e shtoi vrullin e presioneve tashmë në rritje inflacionare. Me Rusinë dhe Ukrainën si eksportuesit kryesorë të grurit, që së bashku plotësojnë një të katërtën e furnizimit global, është materializuar një valë tjetër e rritjes së çmimeve të ushqimeve. Veç kësaj, Rusia është eksportuesi më i madh në botë i plehrave bujqësore, ndërsa Ukraina është eksportuesi më i madh i vajit të lulediellit dhe eksportuesi i katërt më i madh i misrit. Si rezultat i luftës, çmimet e energjisë u rritën ndjeshëm. Nafta e papërpunuar Brent ishte mesatarisht 116 dollarë/fuçi në mars 2022, një rritje prej 55 për qind krahasuar me dhjetorin 2021⁴. Rusia është eksportues kryesor i gazit natyror, dhe gjithashtu plotëson një pjesë të madhe të eksporteve globale të qymyrit dhe naftës së papërpunuar. Evropa importon një pjesë të konsiderueshme të energjisë së saj nga Rusia, duke përfshirë gazin natyror (35 për qind), naftën bruto (20 për qind) dhe

qymyrin (40 për qind). Teksa furnizimi me naftë dhe gaz nga Rusia mund të vazhdojë në mjedisin aktual të dominuar nga sanksionet, ka risqe për ndërprerje të rëndësishme në rrugët kryesore të tranzitit të gazit dhe transakcionet financiare të lidhura me energjinë.



ÇMIMET GLOBALE TË USHQIMEVE U RRI TËN PËR

29.3%

(NGA VITI NË VIT) GJATË VITIT 2021

⁴ Banka Botërore, Perspektiva e Tregjeve të Mallrave Bazë, prill 2022



Nga këndvështrimi i politikave, marrë parasysh nivelet e varfërisë në Kosovë dhe përqendrimin e presioneve në çmimet e ushqimeve, fokusi i menjëhershëm duhet të mbetet në mbrojtjen e qytetarëve më të rrezikuar nga varfëria, të cilët ishin edhe më të prekurit nga tronditja e fundit e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Shmangia e presioneve të mëtejshme mbi ndërmarrjet përmes rritjes së kostove të punës dhe të inputeve do të jetë po ashtu e rëndësishme për t'i frenuar pritjet inflacionare.



do të ketë ndikim të menjëhershëm në mirëqenien dhe varfërinë e familjeve - veçanërisht nëpërmjet rritjes së çmimeve të energjisë - duke paraqitur sfida të rëndësishme për politikëbërësit.

Në Kosovë, rimëkëmbja ekonomike e vitit 2021 vazhdoi së bashku me presionet e rritura inflacionare, veçanërisht nga jashtë. Si importuese neto e ushqimit dhe energjisë, Kosova përjetoj presione më të forta inflacionare për shkak të luftës në Ukrainë. Inflacioni i çmimeve të konsumit, i nxitur kryesisht nga çmimet më të larta të importeve, u rrit në 3.4 për qind në vitin 2021, një rritje prej 3.2 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2020. Bazuar në shifrat e fundit, norma vjetore (nga viti në vit) e inflacionit e matur në prill 2022 ishte 11.2 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, çmimet e ushqimeve dhe transportit në prill 2022 janë rritur përkatësisht për 15.2 dhe 19.4 për qind. Inflacioni mesatar i

çmimeve të importit, me vlerë mesatare prej 11.1 për qind, u intensifikua nga tremujori i dytë i vitit 2021 e në vazhdim, duke arritur përkatësisht në 14.7 për qind dhe 19.7 për qind gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit. Si përgjigje, çmimet e prodhimit, ndërtimitarisë dhe inputeve bujqësore shënuan rritje gjatë vitit 2021 dhe lufta në Ukrainë i përforcoi më tej presionet inflacionare si mbi çmimet e importit ashtu edhe mbi inputet e prodhimit. Marrë parasysh pjesën e madhe të aktivitetit të ndërtimitarisë në investimet e ndërmarrjeve të Kosovës dhe pjesën e përgjithshme të ndërtimitarisë në vlerën e shtuar, ndikimi i rritjes së fundit të çmimeve të inputeve të ndërtimit kërkon monitorim nga afër të sektorit në vitin 2022.


Për të ardhmen, edhe parashikimet tona fillestare – duke përdorur të dhënat e disponueshme deri në shkurt 2022 – sugjerojnë që inflacioni total i konsumit

në Kosovë do të përshpejtohej për të paktën 1/3 gjatë vitit 2022, duke u luhatur mes 5 dhe 6 për qind krahasuar me vitin 2021. Ky parashikim supozon nivele të ngritura të çmimeve, por që normalizohen gradualisht në gjysmën e dytë të vitit, pas pritjeve për ulje të presioneve globale inflacionare. Megjithatë, me inflacionin e çmimeve të konsumit që kapi nivelin më të lartë historik në Prill 2022, norma mesatare vjetore e inflacionit mund të arrijë lehtësisht në 9 për qind nëse presionet globale nuk ulen deri në fund të vitit. Risqet e presioneve të zgjatura janë shtuar. Teksa lidhjet e drejtpërdrejta tregtare të Kosovës me Rusinë dhe Ukrainën janë të kufizuara dhe të përqendruara në metalet bazë dhe produktet minerale, inflacioni tashmë është nxitur indirekt nga çmimet ndërkombëtare të mallrave bazë, duke përfshirë ato ushqimore. Kosova importon mesatarisht 40 për qind të nevojave të saj për grurë dhe ka një varësi edhe më

ÇMIMET E USHQIMIT



ÇMIMET E TRANSPORTIT



Bazuar në shifrat e fundit, norma vjetore (nga viti në vit) e inflacionit e matur në prill 2022 ishte 11.2 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, çmimet e ushqimeve dhe transportit në prill 2022 janë rritur përkatësisht për 15.2 dhe 19.4 për qind. Inflacioni mesatar i çmimeve të importit, me vlerë mesatare prej 11.1 për qind, u intensifikua nga tremujori i dytë i vitit 2021 e në vazhdim, duke arritur përkatësisht në 14.7 për qind dhe 19.7 për qind gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit.

të madhe nga importi për produkte të përzgjedhura bujqësore. Ndalimet e eksporteve të produkteve bujqësore në rajon, mund t'i përkeqësojnë ndjeshëm presionet inflacionare. Kosova gjithashtu importon gjithë konsumin e derivateve dhe një pjesë të konsumit të energjisë elektrike, veçanërisht gjatë stinës së dimrit. Vazhdimi i çmimeve të larta të energjisë elektrike mund ta përkeqësojë furnizimin me energji elektrike dhe ta rrisë më tej koston fiskale të subvencionimit të importeve të energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë, eksportet e metaleve bazë mund të përfitojnë nga mungesat globale të shkaktuara nga lufta në Ukrainë dhe të përshpejtojnë vëllimet dhe çmimet e eksporteve.

Nga këndvështrimi i politikave, marrë parasysh nivelet e varfërisë në Kosovë dhe përqendrimin e presioneve në çmimet e ushqimeve, fokusi i menjëhershëm duhet të mbetet në mbrojtjen e qytetarëve më të

rrezikuar nga varfëria, të cilët ishin edhe më të prekurit nga tronditja e fundit e shkaktuar nga pandemia COVID-19. Shmangia e presioneve të mëtejshme mbi ndërmarrjet përmes rritjes së kostove të punës dhe të inputeve do të jetë po ashtu e rëndësishme për t'i frenuar pritjet inflacionare. Në të njëjtën kohë, veprimet e politikave duhet të fokusohen në ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe në ndërmarrjen e reformave strukturore për të mbështetur rritjen dhe për të ruajtur drejtimin gjatë krizave. Me një hapësirë të kufizuar fiskale, Kosovës do t'i duhet t'i peshojë me kujdes kostot dhe përfitimet e zotimeve të reja për shpenzime si përgjigje ndaj rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, duke u dhënë përparësi familjeve më të rrezikuara. Në këtë kontekst, marrë parasysh mbizotërimin e presioneve inflacionare nga ana e ofertës, masa e diskutuar së fundi për të lejuar një raund të dytë të tërheqjeve

nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës kundrejt detyrimit të Qeverisë për t'i kompensuar tërheqjet, jo vetëm që do të vendoste qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit pensional në rrezik, por do të nxiste më tej inflacionin dhe nuk do të arrinte t'i drejtonte burimet e kufizuara publike të Kosovës drejt familjeve më të prekura nga inflacioni. Masat duhet të jenë të shënjestruara dhe të kufizuara në kohë. Përmirësimi i përmbushjes tatimore, përdorimi i shënjestrimit të varfërisë në programet e mbrojtjes sociale, së bashku me ndërtimin e qëndrueshmërisë energjetike përmes investimit në burimet e ripërtërishe dhe eficiencën e energjisë, duhet të mbeten në krye të agjendës së politikave. Nga ana tjetër, Kosova duhet ta shfrytëzojë momentumin e eksportit të krijuar që nga viti 2020 duke rritur konkurrueshmërinë përmes kostos më të ulët lidhur me pajtueshmërinë rregullative dhe përmes digjitalizimit të përshpejtuar.



GEM MALOKU
ANËTAR I BORDIT MENAXHUES
NLB BANK

Ndikimet e inflacionit në ekonominë reale

Inflacioni është ulja e vlerës së parasë në këmbim të produkteve ose shërbimeve të disponueshme në treg. Janë disa arsye që nxisin inflacionin, inflacionin i nxitur nga kosto dhe inflacionin i nxitur nga kërkesa, varësisht nga elementi nxitës i inflacionit.

Inflacioni i nxitur nga kosto rrjedh nga rritja e çmimeve të mallrave bazë, gjë që më së shpeshti nxitet ose shkaktohet nga rritja e çmimit të burimeve të energjisë siç është nafta. Ndërkohë, rritja e intensifikuar ekonomike mund të shkaktojë inflacion edhe për shkak të rritjes së aktiviteteve ekonomike që rrisin kërkesën, e cila nuk mund të ndiqet nga produktiviteti i vendit. Pozicione të tilla njihen edhe si hiperinflacion, kurse gjatë ngadalësimit të ciklit ekonomik zvogëlohet intensiteti i kërkesës duke lejuar që produktiviteti i vendit të përputhet me kërkesën, çka rezultojnë në uljen e normës së inflacionit.

Me fjalë të tjera, nëse shtypja e monedhës në ekonomi është më shumë se produktiviteti i vendit, kjo rezultojnë në një disbalancë të njohur si inflacion, ose humbje të vlerës së parasë. Për t'i stabilizuar trendet e inflacionit, qeveritë priren të rregullojnë ritmin e aktiviteteve ekonomike nëpërmjet ofertës monetare (parasë në qarkullim), e cila njihet si politika monetare

dhe sponsorizohet nga bankat qendrore. Një intervenim i tillë reflekton masa makroprudenciale që aktivizojnë reduktimin e ofertës së parasë së gatshme, përmes rritjes së normave të interesit apo rritjes së rezervave të likuiditetit për bankat, për uljen e kapaciteteve kredituese bankare dhe reduktimin e fluksit të parasë në ekonomi, duke ndikuar kështu drejt trendit të zvogëlimit të inflacionit.

Megjithëse trendet e inflacionit mund të nxiten nga intensiteti i rritjes ekonomike, inflacioni gjithashtu ndikon në ngadalësimin e rritjes ekonomike, në varësi të intensitetit dhe përhapjes. Gjatë periudhave të larta inflacioniste, ritmi i rritjes ekonomike zvogëlohet për shkak të rënies së fuqisë blerëse të ekonomisë reale, nëse ky mjedis i tillë i inflacionit

të lartë vazhdon për një periudhë më të gjatë. Norma aktuale e inflacionit janë nxitur nga rritja e çmimeve për burimet e energjisë, intervenimet e qeverisë në BE, SHBA dhe në mbarë botën me politika fiskale për shkak të COVID-19, zinxhiri i destabilizuar i furnizimit i shoqëruar me ndikim të rëndësishëm nga kriza e prodhuar nga lufta në Ukrainë.

Zhvillimet e fundit me inflacionin kanë pasur ndikimet e veta në ekonominë e Kosovës, kryesisht përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara. Kosova ka një bilanc



INFLACIONI I NXITUR NGA KOSTO RRJEDH NGA RRRITJA E ÇMIMEVE TË MALLRAVE BAZË, GJË QË MË SË SHPESHTI NXITET OSE SHKAKTOHET NGA RRRITJA E ÇMIMIT TË BURIMEVE TË ENERGJISË SIÇ ËSHTË NAFTA.

Inflacioni i Kosovës është inflacion i importuar, duke ndikuar negativisht në indeksin e IÇK-së përmes rritjes së çmimeve për produktet bazë të konsumit. Marrë parasysh se monedha e Kosovës është euro, nuk ka kërcënim që rrjedh nga disbalanca ndërmjet produktivitetit vendor dhe ofertës monetare për shkak të shtypjes së parasë vendore, por ka një disavantazh të mungesës së politikës monetare dhe mekanizmave të saj të cilët mund të shfrytëzohen në vende të tjera.



tregtar negativ, që përkthehet në një vend shumë të varur nga importi, i ndikuar kështu nga rritja e çmimeve në mbarë botën. Inflacioni i Kosovës është inflacion i importuar, duke ndikuar negativisht në indeksin e IÇK-së përmes rritjes së çmimeve për produktet bazë të konsumit. Marrë parasysh se monedha e Kosovës është euro, nuk ka kërcënim që rrjedh nga disbalanca ndërmjet produktivitetit vendor dhe ofertës monetare për shkak të shtypjes së parasë vendore, por ka një disavantazh të mungesës së politikës monetare dhe mekanizmave të saj të cilët mund të shfrytëzohen në vende të tjera.

Nëpërmjet politikës monetare, Banka Qendrore do të mund të ndikonte në ofertën monetare në treg nëpërmjet ndryshimit të normave të interesit. Si pjesë e veprimeve të tilla, masat më të fundit të marra nga FED në SHBA, ishin rishikimi i normave të interesit, çka do të rrisë koston e ofertës monetare në ekonomi dhe do të ngadalësojë potencialisht trendin e inflacionit.

Duke pasur një norme inflacioni në rangun prej 10% (të dhënat e fundit të publikuara deri në mars 2022) në ekonominë e brishtë të Kosovës me bilanc të konsiderueshëm negativ tregtar, rezultojnë drejtpërsëdrejti në dobësimin e fuqisë blerëse të ekonomisë reale, duke ndikuar në balancin fiskal dhe duke rezultuar kështu drejt luhatshmërisë në kapacitetin për shlyerje të borxhit të vendit.



NËPËRMJET POLITIKËS MONETARE, BANKA QENDRORE DO TË MUND TË NDIKONTE NË OFERTËN MONETARE NË TREG NËPËRMJET NDRYSHIMIT TË NORMAVE TË INTERESIT.

Implikimet e para që rrjedhin nga inflacioni në ekonominë e Kosovës gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 u reflektuan në rritjet e ndjeshme të çmimeve, që kërkon ofertë monetare shtesë për t'u shfrytëzuar nga ekonomia reale për të përballuar nevojat për furnizime. Një trend i tillë ka rezultuar në rritjen e përdorimit të produkteve kreditore të aprovuara nga ekonomia reale, duke rritur kështu përdorimin e likuiditetit të sektorit bankar drejt ekonomisë me ritme më të larta krahasuar me trendet nga viti në vit.

Pozicioni ekzistues i qëndrueshëm i likuiditetit të sektorit bankar, arriti të shërbejë me një ofertë të tillë për ekonominë dhe të mbështesë nevojat me të cilat përballet ekonomia nga çmimet e ngritura dhe rritja e nevojave për kapital punues të kompanive. Në rrethana të tilla, një faktor kritik i suksesit të ekonomisë reale është bartja e çmimeve të rritura drejt klientëve të tyre dhe

aftësia e klientit/shfrytëzuesit të fundit për t'i përballuar këto rritje të çmimeve. Një efekt anësor i mëtejshëm i çmimeve të ngritura ndaj konsumatorëve dhe kundrejt elasticitetit të çmimit të kërkesës, i dha shenjat e para me ngadalësimin e investimeve drejt cikleve të biznesit me inventar/stoqe me lëvizje të ngadalta, siç është ndërtimearia.

Ky trend i inflacionit rëndohet në të hyrat mujore familjare dhe aftësisë së tyre për të ndjekur trendin e rritjes së inflacionit, çka deri tani nuk ka mundur të realizohet brenda vendit, përderisa pagat



Deri në
25 vjet

NLB Kredi Hipotekare

Mundësia për të jetuar jetën në mënyrën tuaj.

NLB Banka

e fuqisë punëtore kanë mbetur të njëjta. Një pozicion i tillë statik i të hyrave ngre dyshime për qëndrueshmërinë e ekonomisë së Kosovës përballë trendeve të tilla të inflacionit. Nisur nga trendi aktual, është e dukshme që efekti i inflacionit nuk është kalimtar dhe do të ketë edhe efektet e tij afatgjata.

Ndërkohë, ekonomia e Kosovës është dukshëm e varur dhe ushqehet nga remitancat që vijnë kryesisht nga vendet e BE-së, të cilat në baza vjetore arrijnë pothuajse mbi 1 miliard euro; në të njëjtën kohë një fluks i tillë i remitancave mund të mbulojë

deri në një masë presionet inflacioniste kur bëhet fjalë për konsumin ditor dhe komponentë të IÇK-së, duke supozuar se pagat brenda vendeve të BE-së do të pasqyronin normën e inflacionit. Kështu, duke mbrojtur pozitivisht fuqinë blerëse të familjeve, mbështeten nevojat e tyre të konsumit.

Ndërsa këndvështrimi i investitorëve, kërkimi i kthimit të investimeve të tyre pra, është ndikuar dhe do të ndikohet në afat të gjatë nga inflacioni. Tkurrja afatgjatë nën presionin e rritur inflacionist ndikon drejtpërdrejt në profitabilitetin e

projekteve të investimeve afatgjata. Kështu, si zakonisht, praktika e biznesit në ekonominë e Kosovës nuk përfshin si pjesë të marrëveshjes dypalëshe përfshirjen e efekteve të inflacionit, çka do ta mbronte pozicionin afatgjatë kontraktues të investitorëve. Në rrethana të tilla, kontratat afatgjata të dakorduara paraprakisht pa inflacion do të rezultojnë në implikime negative tek profitabiliteti për investitorët për shkak të çmimit të dakorduar paraprakisht me blerësin/kontraktorin. Situata e tillë do ta japë efektin e saj të parë anësor drejt rritjes së nevojave për kapital punues nga biznesi kosovar, i cili do të konsumohej nga çmimet e rritura duke ndikuar drejtpërdrejt në fuqinë blerëse të investitorit, duke krijuar një cenueshmëri ndaj kthimit të borxhit për shkak të përkeqësimit të rrjedhës së pasare dhe pozitës së profitabilitetit. Përderisa vendet e zhvilluara do t'i shpalosin masat e tyre ndaj inflacionit, siç është rritja e normave të interesit si një nga masat e zakonshme dhe të menjëhershme, veprime të tilla do të kenë efektin e tyre edhe në ekonominë e Kosovës, por në një masë më të kufizuar. Huamarrja nga bankat me norma fikse interesi për situata të tilla përfaqëson një pozicion të mbrojtur të huamarrësit. Megjithatë, kreditë me norma të ndryshueshme të interesit të cilat janë lëshuar në tregun e Kosovës dhe të cilat kanë pikë referimi EURIBOR-in, do të ndikohen kur të rritet norma referente. Një rritje e tillë do të ndikojë në rritjen e kostos së jetesës për personat fizik.

Nga ana tjetër, efektet e inflacionit do të kenë ndikimin e tyre edhe në sektorin bankar, në një mjedis me inflacion intensiv prej 10%. Investimet e sektorit bankar drejt ekonomisë reale janë në intervalin më të ulët se norma e inflacionit, marrë parasysh se norma mesatare e interesit për personat juridikë është 5.7% dhe për individët është 5.97%, duke pasur parasysh një prani afatgjatë të inflacionit të lartë.

Prandaj, adresimi i një implikimi kaq të gjerë që rrjedh nga mjediset inflacioniste për Qeverinë e Kosovës përbën një ushtrim mjaft sfidues, i cili si i tillë paraqet një sfidë të rëndësishme edhe për vendet e zhvilluara. Ndërkohë, Qeveria mund të konsiderojë përdorimin e disa mekanizmave makroprudencialë për t'i harmonizuar aktivitetet më gjerë dhe të akorduara/koordinuara për ta përballuar inflacionin dhe implikimet negative ndaj ekonomisë së Kosovës. Megjithatë masat e ndërmarra për menaxhimin apo kontrollimin e inflacionit mund të shpijnë edhe drejt krizës ekonomike (recesionit ekonomik) të njohur si "hard landing". Bazuar në praktikën e deritanishme të ekonomive të zhvilluara menaxhimi i inflacionit ka prodhuar një krizë ekonomike si rezultat i ngadalësimit të zhvillimit ekonomik të ndikuar nga masat e ndërmarra. Rrjedhimisht qenësorë është balancimi i masave të ndërmarra për të kontrolluar inflacionin duke mos nxitur tkurrje ekonomike si rezultat anësor.



NDËRKOHË, EKONOMIA E KOSOVËS ËSHTË DUKSHËM E VARUR DHE USHQEHET NGA REMITANCAT QË VIJNË KRYESISHT NGA VENDET E BE-SË.



ANITA KOSUMI-AJETI
UDHËHEQËSE E DEPARTAMENTIT TË BURIMEVE NJERËZORE
BANKA PËR BIZNES

Zhvillimi i kapitalit njerëzor, trajnimet dhe Akademia e Burimeve Njerëzore

Me ripozicionim në treg të Bankës për Biznes, është rritur nevoja për zhvillimin e kuadrove të brendshme të institucionit, që gjithashtu do të ishin ndihmesë edhe në fazat tjera të rritjes graduale të bankës. Duke parë këtë si domosdoshmëri, BPB ka tashmë disa vite që ka nisur programin BPB Junior, që fillimisht, kishte nisur si ide për orientimin e studentëve në karrierë si dhe rekrutimin e stafit të ri brenda institucionit. Studentët e përzgjedhur për këtë program trajnohen për tre muaj me radhë nga ekspertët më të mirë të fushës së bankingut dhe jo vetëm.

Ky program, është hartuar në atë formë që të përgatisë listën më të mirë të aplikantëve, shifra e të cilëve tashmë nga të gjitha programet ka arritur në mijëra aplikues, studentë të universiteteve publike dhe private në vend, për të vazhduar pastaj edhe në testimin, selektimin dhe trajnimin e tyre, duke gjetur pikat e tyre më të forta

profesionale që do t'i drejtonin të njëjtët drejt një karriere në sektorin bankar, por jo vetëm.

BPB si pjesë e reformës për transformim institucional, nga ky program ka arritur të rekrutojë mbi 50 të rinj që kanë ndjekur programin, duke i pozicionuar



BPB KA TASHMË DISA VITE QË KA NISUR PROGRAMIN BPB JUNIOR, QË FILLIMISHT, KISHTË NISUR SI IDE PËR ORIENTIMIN E STUDENTËVE NË KARRIERË SI DHE REKRUTIMIN E STAFIT TË RI BRENDA INSTITUCIONIT.

të njëjtët në departamentet dhe degët e bankës, për të cilat ata kanë treguar interes dhe pikat më të forta përgjatë këtyre tre muajsh sa zgjat programi.

Ajo se çka e dallon BPB Junior nga programet e tjera që në thelb pos trajnimit kanë edhe rekrutimin, është vet mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve dhe testimet që bëhen në fazat paraprake. Vizitat në institucione tjera në vend, por edhe ligjëratat që nga menaxhmenti ekzekutiv dhe udhëheqësit e departamenteve, ndërkaq, u japin kandidatëve të përzgjedhur idenë e orientimit të tyre në karrierë.

Tashmë, veçse është finalizuar lista e gjeneratës së pestë dhe trajnimet do të mbahen në një ambient të ri të institucionit që banka ka inaguruar.

“HR Academy from BPB”, është projekti për të cilin jemi më së shumti entuziast, për vetë faktin e formave se si gërshetohen modulet e trajnimeve, ku sigurisht përfshihet edhe programi



“HR Academy from BPB”, është projekti për të cilin jemi më së shumti entuziast, për vetë faktin e formave se si gërshetohen modulet e trajnimeve, ku sigurisht përfshihet edhe programi BPB Junior, që po shënon gjysmë dekadë të funksionimit.



BPB Junior, që po shënon gjysmë dekadë të funksionimit. Të vetëdijshëm që e ardhmja e punës ka në fokus kërkesat lidhur me kapitalin njerëzor, si Departamenti i Burimeve Njerëzore e kemi transformuar në një nivel tjetër pjesën e avancimit të brendshëm, duke prekur në këtë mes pikat më të ndjeshme që ne kemi identifikuar gjatë analizave tona.

Gati 400 punonjësve të BPB-së, përmes kësaj akademie ne u mundësojmë zhvillimin e tyre profesional, duke i njohur me mjedise të reja, pikërisht, përmes moduleve të hartuara nga ekspertët më të mirë të fushës.

Me Akademinë e Burimeve Njerëzore, që veçse po zhvillohet edhe më tutje, sipas kurrikulave të hartuara dhe projeksioneve tona, ne jemi të bindur që e kemi përmbushur një detyrë të rëndësishme lidhur me avancimin e brendshëm dhe sigurisht si pjesë të saj edhe kuadrot e reja.

BPB është e përkushtuar për të zhvilluar edhe më tutje Akademinë, duke pasur qëllim kryesor përhapjen e strategjisë së bankës te

punonjësit, në mënyrë që të gjithë të ndihen pjesë dhe të angazhuar me vizionin e saj, dhe të mund të kontribuojnë çdo ditë në qëllimet afatgjate.

Për më tepër, do të sigurohen programe të vazhdueshme të zhvillimit, sepse më duhet të theksojmë se BPB është e orientuar për promovimet e brendshme dhe Akademia do t'i ndihmojë punonjësit tanë t'i zhvillojnë këto aftësi edhe më tej. Ekipet e dedikuara në Bankë do të ndjekin dhe monitorojnë ciklin e zhvillimit të punonjësve dhe rrugën e tyre të karrierës hap pas hapi, duke trajnuar dhe ndërtuar aftësitë e tyre të nevojshme sipas rrugës së tyre të karrierës.

Të mësuarit në mënyrë elektronike, apo E-learning, do të jetë një metodë tjetër e

mbajtjes së trajnimeve të shumta për punonjësit e Bankës sonë. Trajnimet online janë mbështetur theksueshëm gjatë situatës pandemike, duke rritur entuziazmin, fleksibilitetin dhe efikasitetin e stafit.

BPB është zotuar të harmonizojë strategjinë e saj të biznesit për të qenë në përputhje me qëllimet e shoqërisë për të kontribuar në të. Me pak fjalë, BPB nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e një vendi pune, por ka të bëjë me ofrimin e karrierës dhe mundësive të zhvillimit, andaj, përmes projekteve të tilla si Akademia e Burimeve Njerëzore ne e përmbushim edhe një detyrim të rëndësishme që kemi ndaj punonjësve tanë.





ANA GOGA
DREJTORE E DIVIZIONIT FINANCIAR, CFO
CREDINS BANK KOSOVA

Rritja e inflacionit do të vazhdojë të përforcojë pabarazinë, si brenda dhe ndërmjet vendeve

I Kthimi i inflacionit global

Pas gati katër dekadash, inflacioni është bërë shqetësimi i sotëm i ekonomive të përparura dhe ekonomive në zhvillim në të gjithë botën. Duket se këtë herë inflacioni u rikthye më shpejt, më i dukshëm dhe ndoshta është më i qëndrueshëm nga sa e perceptuan bankat qendrore në fillim. Një zhvillim që ndikon në inflacion, që është i zakonshëm në vendet e përparura dhe në zhvillim, është rritja e çmimeve të mallrave krahas rritjes së kërkesës globale. Sot po përjetojmë një tjetër ngjarje të madhe, luftën në Ukrainë, e cila jo vetëm ka krijuar vuajtje të jashtëzakonshme njerëzore, por ka dëmton edhe ekonominë globale në një fazë kritike. Jo vetëm që ka ndikuar në rritjen e mëtejshme të çmimeve të energjisë dhe mallrave, por ka rritur ndjeshëm edhe pasigurinë globale, të cilat minojnë rritjen. Pasojat e luftës dhe sanksionet që pasuan vazhdojnë të kumbojnë. Rezistenca e sistemit

financiar global do të testohet përmes kanaleve të ndryshme të amplifikimit të mundshëm. Evropa mbart një rrezik më të lartë se rajonet e tjera për shkak të afërsisë së saj gjeografike me luftën, mbështetjes në energjinë ruse dhe ekspozimit jo të papërfillshëm të disa bankave dhe institucioneve të tjera financiare ndaj aktiveve dhe tregjeve financiare ruse. Për më tepër, paqëndrueshmëria e vazhdueshme në çmimet e mallrave mund të bëjë presion të madh mbi financimin e mallrave dhe tregjet e derivateve dhe madje mund të shkaktojë më shumë ndërprerje si luhatjet e egra që ndaluan disa tregtime të nikelit muajin e kaluar. Episode të tilla, mes pasigurisë së shtuar gjeopolitike, mund të rëndojnë mbi likuiditetin dhe kushtet e financimit. Një çështje tjetër kryesore që prek këtë tregues është zinxhiri global i furnizimit, i cili vazhdon të jetë i rëndë nga bllokimi i fundit i Kinës për shkak të rritjes

së numrit të infeksioneve Covid-19. Kostot e transportit janë rritur shumë. Tipari më i dukshëm i inflacionit të sotëm është gjithëprania e tij. Në mungesë të opsioneve të politikës globale për të zgjidhur ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit, detyra e adresimit të inflacionit do t'i bie bankave qendrore kryesore botërore. Për të qenë të sigurt, një përgjigje më në kohë dhe më e fortë e politikave nga bankat kryesore qendrore nuk do të ishte një lajm i mirë për tregjet në zhvillim dhe ekonominë në zhvillim në afat të shkurtër. Shumica do të përjetonin kosto më të larta financimi dhe krizat e borxhit mund të bëhen dukshëm më të mundshme për disa. Bazuar në vlerësimet e FMN-së, rritja e pasigurisë në tremujorin e parë mund të jetë e mjaftueshme për të ulur deri në 0.35 pikë përqindje rritjen globale gjatë gjithë vitit. Inflacioni pritet të mbetet i lartë globalisht gjatë muajve të ardhshëm deri në

“Rritja e inflacionit do të vazhdojë të përforcojë pabarazinë, si brenda dhe ndërmjet vendeve.”



II Ndikimi i inflacionit global në rajonin e Ballkanit

vitin 2023. Në tregjet në zhvillim, shumë banka qendrore tashmë kanë shtrënguar ndjeshëm politikën. Ata duhet të vazhdojnë ta bëjnë këtë - në varësi të rrethanave individuale - për të ruajtur besueshmërinë e tyre për të luftuar inflacionin dhe për të ankoruar pritshmëritë e inflacionit. Normat e interesit mund të duhet të rriten përtej asaj të parashikuar për të mbajtur inflacionin në objektiv në kohën e duhur. Kjo mund të sjellë shtyrjen e normave të interesit shumë mbi nivelin e tyre neutral. Për bankat qendrore të ekonomisë së përparuar, komunikimi i qartë është thelbësor për të shmangur paqëndrueshmërinë e panevojshme në tregjet financiare, duke ofruar udhëzime të qarta për procesin e shtrëngimit, ndërkohë që mbeten të varura nga të dhënat. Rezerva Federale ka rritur dy herë deri më tani normën bazë të interesit, e ndjekur nga Banka e Anglisë. Banka Qendrore Evropiane nuk ka bërë ende asnjë ndryshim në normat bazë të interesit. Duke u kthyer në rajonin tonë, Banka Qendrore e Serbisë vendosi të rrisë normën bazë me 50 bp, në 1.5%. Kjo rritje shoqërohet me rritje të normës së repove dhe të

lehtësive të depozitave dhe kreditimit. Banka Qendrore e Shqipërisë bëri të njëjtën gjë, duke rritur normën bazë të interesit me 50 bp në 1% (në nivelet para pandemisë), por mbajti të pandryshuara normat e depozitave dhe të kredisë. Banka Popullore e Maqedonisë, vendosi të rrisë normën e interesit për bonot BQ për 0,25% në 1,5%, kryesisht si kundërpërgjigje parandaluese ndaj pritjeve në rritje inflacioniste. Ndërkohë, bankat qendrore të Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Kosovës nuk kanë ndërmarrë ende asnjë veprim edhe pse inflacioni është mbi nivelin e tyre të synuar. Këto vendime synojnë të kontrollojnë rritjen e mëtejshme të inflacionit, por në të njëjtën kohë të mos kenë një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendeve, të cilat janë ende në rikuperimin e viteve të pandemisë. Megjithatë, rreziku në rritje i inflacionit ndaj të cilit janë të ekspozuara të gjitha ekonomitë e Ballkanit, është rritja e mëtejshme e çmimeve të energjisë, gazit natyror, naftës dhe plehrave kimike për shkak të luftës në Ukrainë. Inflacioni ul fuqinë blerëse të popullsisë, gjë që do të reflektohet në uljen e konsumit

personal, që është komponenti kryesor i PBB-së së Ballkanit Perëndimor. Rritja e kostove të transportit është një rrezik shtesë për biznesin e kompanive në rajon. Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga bankat qendrore të vendeve të Ballkanit, ritmi i rritjes së PBB-së ose viti 2022 dhe 2023 është rishikuar në rënie në parashikimin fillestar të kryer në vitin 2021 për shkak të pasojave të situatës aktuale. Rritja e mëtejshme e çmimit të naftës do të sillte gjithashtu një rritje të deficitit të llogarisë korrente (bilanci i pagesave) në të gjitha ekonomitë e Ballkanit, si dhe në rritje të deficitit të tregtisë së jashtme. Nga ana tjetër, rritja e inflacionit dhe e normës bazë të interesit do të ndikojë në rritjen e normës së interesit të kreditimit, të depozitave dhe të letrave me vlerë të qeverisë në tregjet financiare. Rritja e fundit nënkupton rritje të borxhit të qeverisë dhe të deficitit buxhetor vjetor. Rritja e normës së interesit të kredisë do të rrisë rrezikun kreditor të huamarrësit dhe do të kërkonte shtrëngim të politikave dhe procedurave të kreditimit të bankave. Në këto kushte jemi në pritje të një qëndrueshmërie financiare globale.



ARIJAN HAXHIBEQIRI
ZV/KRYESHEF EKZEKUTIV
BANKA EKONOMIKE

Efektet zinxhirore si rezultat i presioneve globale inflacioniste

Dy vitet e fundit janë karakterizuar me vështirësi të shumta ekonomike dhe sociale, që nga Pandemia deri tek lufta mes Rusisë dhe Ukrainës duke shkaktuar “tronditje” edhe tek ekonomitë më të fuqishme botërore siç është ekonomia Amerikane. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, pritjet e ngritjes të inflacionit në Amerikë gjatë muajit mars kanë qenë në nivelin 8.5%, që është më e larta në 40 vitet e fundit! Trendet e njëjta rritëse të inflacionit kanë përfshirë edhe shtetet e Eurozonës ku pritjet e shkallës së inflacionit gjatë muajit mars kanë qenë në shifrat 7.5%!

Që nga fillimi i invazionit të Rusisë në Ukrainë, çmimi i naftës dhe gazit natyror ka shënuar rritje të lartë. Marrë parasysh faktin e varshmërisë së shteteve të Unionit Evropian në nivelin e 40% nga importi i gazit natyral nga Rusia, që përfaqëson edhe burimin kryesor të energjisë për këto shtete, rritja e çmimit të energjisë është një ndër shkaktarët kryesor të rritjes së inflacionit në shtetet e unionit Evropian. Për më shumë, vështirësitë/ ndërprerjet e shkaktuara në zinxhirin furnizues si dhe kërkesës së ngritur, që nga periudha e pandemisë e në veçanti

nga nisja e konfliktit Rusi-Ukrainë, si dhe së fundmi, vendosja e sanksioneve financiare, politike nga ana e shteteve perëndimore ndaj Rusisë, kanë ndikuar në ngritjen e çmimeve për produkte dhe shërbime në nivel global.

Ngritja e çmimit të energjisë dhe bilanci negativ tregtar i Kosovës (sipas Agjencisë të Statistikave të Kosovës, të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 41.7% në muajin janar 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021. Eksporti mbulon importin me 19.0%), respektivisht varshmëria e Kosovës në masë të madhe nga importi i produkteve dhe shërbimeve ka ndikuar

INDEKSI I TËRËSISHËM I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT ËSHTË MË I LARTË NË NJË MESATARE PREJ

7.5%

NË MUAJIN SHKURT 2022, KRAHASUAR ME MUAJIN SHKURT 2021

po ashtu në ngritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve në Kosovë dhe regjion! Në kontekstin e impaktit negativ të inflacionit në Kosovë, impakti është gjithëpërfshirës, si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në aspektin social. Sa pari, ndikimi i inflacionit ka impakt negativ në mirëqenien e qytetarëve tanë si rezultat i ngritjes së çmimeve të produkteve të konsumit të gjerë (sipas Agjencisë të Statistikave të Kosovës; “Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 7.5% në muajin shkurt 2022, krahasuar me muajin shkurt 2021), së dyti, shumë veprimtari dhe sektorë ekonomik preken nga impakti negativ i ngritjes së çmimeve, në veçanti tek disa sektorë, siç mund të jetë sektori i ndërtimit, së treti, ngritja e çmimit të energjisë ndikon po ashtu negativisht edhe në sektorin e prodhimit, duke ngritur koston e prodhimit për produkte vendore, së fundmi dhe jo vetëm, efekti zinxhiror i ngritjes së çmimeve në një masë do përfshinte të gjitha veprimtaritë ekonomike, rrjedhimisht do shkaktojë uljen e nivelit të zhvillimit ekonomik për vitin 2022.

**Banka
Ekonomike**

Mendon për ty!

**Banka e vetme
100% vendore**

Siguroni pronën tuaj

të financuar nga Banka





FISNIK LATIFI
MENAXHER I TË ARDHURAVE FIKSE
RAIFFEISEN BANK KOSOVË

Menaxhimi i pasurisë në periudha inflacioniste

Si koncept ekonomik, norma e inflacionit është e rëndësishme pasi përfaqëson shkallën në të cilën korrodohet vlera reale e një investimi me kalimin e kohës. Për investitorët, kjo matje tregon saktësisht sasinë e kthimit që duhet të sjellë investimi i tyre, që ata ta ruajnë fuqinë e tyre blerëse.

Me këtë ide, investitorët duhet të synojnë të gjenerojnë kthime që janë më të mëdha se inflacioni në terma të përqindjes: nëse një investim kthimin e ka 4% kurse inflacioni ishte 5% gjatë të njëjtës periudhë, kthimi efektiv është minus 1%.

Sa më likuid të jetë një aset, ku vlera bazë janë paratë e gatshme, aq më shumë ndikohet nga inflacioni, që do të thotë se ky aset ka më shumë gjasa të zhvlerësohet nga norma e inflacionit. Edhe asetet jolikuide ndikohen nga inflacioni, por me kalimin e kohës ato zakonisht rriten në vlerë dhe gjenerojnë të hyra në formën e interesit ose dividendit. Kjo siguron një mbrojtje natyrore ndaj zhvlerësimit, prandaj investitorët i preferojnë ato asetë në një mjedis inflacioni. Në këtë kuptim, investitorët duhet

të synojnë kthimet që tejkalojnë inflacionin.

Në terma të gjerë, klasat e asetëve nga të cilat ata mund të zgjedhin janë instrumente me të hyra fikse (megjithëse do të shohim se ato mund të mos jenë gjithmonë fikse), ekuitet dhe mallra bazë/commodities.

Të hyrat fikse

Kur investohet në asetë që gjenerojnë të hyra fikse, siç janë obligacionet, kreditë ose qiratë, matësi kyç i performancës së investitorëve është norma e interesit që ata marrin gjatë gjithë periudhës së investimit. Normat e interesit zakonisht kanë disa komponentë të përfshirë në të, siç janë norma pa risk, norma e pritjes e inflacionit për kohëzgjatjen e investimit, dhe elemente idiosinkratike të riskut të kredisë. Investitorët duhet të jenë të vetëdijshëm se norma e pritshme e inflacionit është thjesht një pritshmëri, e cila në realitet mund të jetë e mbi ose e nënvlerësuar. Nëse inflacioni real rezulton të jetë më i ulët se vlera e pritjes, investitorët shpërblehen më shumë seç ishte planifikuar, dhe anasjelltas.

Tani, një investitor mund të mendojë se inflacioni do të rritet më shumë sesa komponenta mbi normën e pritjes të inflacionit e përfshirë në normat aktuale të interesit, kështu që ata mund të dëshirojnë të investojnë në asetë, kthimet e të cilave janë të lidhura me inflacionin. Obligacionet ose qiratë nga pasuritë e paluajtshme shpesh i referohen Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK), që do të thotë se nëse rritet inflacioni, rritet edhe kthimi i investimit. Shembuj konkretë për këtë janë Letrat me Vlerë të Thesarit të Mbrojtura nga Inflacioni (TIPS) ose Trustet e Investimeve në Pasuri të Paluajtshme (REITs). Në mënyrë të ngjashme, obligacionet dhe huatë e lidhura me një normë referencë, siç është Euribor, mund të rrisin normat e interesit, sepse normat e referencës janë të lidhura drejtpërdrejt me inflacionin.

Shkurtimisht, nëse një investitor pret që inflacioni (dhe normat e interesit) të rriten me kalimin e kohës, atij do t'i përshtatet më së miri të investojë në asetë me norma interesi variabile. Nga ana tjetër, nëse ata besojnë se inflacioni do të ulët, ata mund të duan

t'i bllokujnë asetet me normë fikse dhe të vazhdojnë të marrin kthime të larta kur në treg ulen normat.

Ekuiteti


Ngjashëm me të hyrat fikse, kthimet nga investimet në ekuitet duhet të maten me një metrikë kyçe, dhe në këtë rast shumica e investitorëve përdorin normën e kërkuar të kthimit. Kjo normë përcaktohet nga vetë investitorët, të cilët marrin parasysh koston e kapitalit të përdorur, dhe disa supozime parashikuese, si të ardhurat e pritshme, cikli ekonomik dhe inflacioni. Për të përafëruar vlerën reale të një aksioni janë të disponueshme metoda të ndryshme vlerësimi, dhe nëse çmimi i tregut aktual i tregtuar i atij aksioni është më i ulët se vlera e llogarit, investitori mund të zgjedhë ta blejë në këtë aksion, me pritjen që çmimi i treguar i tregut do të konvergjojë drejt vlerës të llogarit.

Jo të gjitha investimet në ekuitet sillen njësoj në periudha inflacioniste: shumica e kompanive ndikohen nga rritja e çmimeve të inputeve: prodhuesit përballen me kosto më të larta në lëndët e para, ndërsa ofruesve të shërbimeve u kërkohet të rrisin kompensimin e punonjësve për të ruajtur konkurrueshmërinë. Megjithatë, disa kompani mund t'ia kalojnë këto kosto të shtuara më lehtë klientëve të tyre se të tjerat. E dimë se artikujt e luksit dhe përgjithësisht sektori për produktet jo esenciale është më i ndjeshëm ndaj

çmimeve sesa, të themi, produktet elementarë të konsumit, si ushqimi ose barnat, apo shërbimet komunale. Investimi në këto të fundit është sjellje defensive, e cila karakterizohet me kthime më të ulëta në fazën e zgjerimit të një cikli ekonomik, por nga ana tjetër është më rezilente në ruajtjen e vlerës gjatë një recesioni.

Duhet të bëhet përzgjedhje e kujdesshme e sektorëve ekonomikë dhe brenda sektorëve të zgjidhen kompani individuale. Këtu është e përshtatshme të kontrollohen pasqyrat financiare të kompanive për qëndrueshmërinë e tyre nën stres. Një kompani me pjesëmarrje të madhe të borxhit në bilancin e vet, mund të ketë kosto më të lartë të shërbimit të borxhit me rritje të normave të interesit gjatë një periudhe inflacioni, dhe si e tillë duhet të shmanget.

Disa industri, të tilla si bankat, kanë më shumë borxh në bilancin e tyre për shkak të modelit të tyre të biznesit. Në këto raste, vlen të shqyrtohet se nga çka përbëhen asetet dhe detyrimet e tyre, për sa i përket ndjeshmërisë së tyre ndaj ndryshimit të normave të interesit. Në kohën e rritjes së normave të interesit, ato banka me detyrime fikse dhe asetë variabile pozicionohen më së miri: ato kanë fiksuar kosto më të ulët të kapitalit kur normat e interesit ishin të ulëta, në anën tjetër ato janë në gjendje të marrin kthime më të larta nga zhvendosjet për lart të tregut. Marzhi i tyre i interesit zgjerohet më shumë.



Në periudha inflacioniste në radhë të parë humbasin kursimtarët, si dhe marrësit e pagesave me normë fikse, si pagat, obligacionet e rregullta dhe qiratë e palidhura me indeks të caktuar.


Mallrat bazë/Commodities

Inflacioni dhe çmimet e mallrave bazë kanë mbase ndërlidhjen më inverse mes të gjitha klasave të asetëve, çka e bën investimin në mallra bazë mbrojtjen e preferuar ndaj çmimeve në rritje.

Tipari dallues i mallrave bazë në krahasim me të hyrat fikse dhe ekuitetet, është se ato zakonisht nuk gjenerojnë vlerë nëpërmjet dividendëve ose interesit. Për më tepër, është e kushtueshme ruajtja dhe sigurimi i tyre, sepse ato janë të natyrës materiale, dhe kanë të kyçur vlerë brenda tyre. Mënyra e tyre e vetme për të krijuar vlerë është përmes rritjes së çmimit të tyre kur shiten.

Pandemia e Covid-19 i ka detyruar kompanitë minerare të mbyllin lokacionet e tyre të prodhimit për metalet industriale dhe të çmuara. Ari, si mbrojtje klasike kundër inflacionit, bakri si pararendës për elektrifikimin e automjeteve dhe zhvillimin e infrastrukturës, alumini dhe metalet e tjera, janë aktualisht në mungesë dhe kjo përfaqëson një fyt të ngushtë në rrjedhën e prodhimit.

Lufta në Ukrainë ka nxjerrë në pah varësinë nga nafta, gazi, drithërat dhe plehrat nga zonat e konfliktit, dhe janë duke u bërë përpjekje për të gjetur zëvendësues adekuat. Mbetet për t'u parë sesa shpejt prodhuesit mund ta plotësojnë kërkesën e ardhshme, por edhe atëherë, ndoshta me çmime më të larta se sot. "Commodities supercycle"



Fituesit janë pozicionet e kundërta, si qeveritë, bankat dhe tregtuesit e borxhit që paguajnë norma fikse ose pranojnë norma variabile.

është një togfjalësh i ri, që aktualisht po fiton më shumë vëmendje në media.

Investitorët mund të fitojnë ekspozim ndaj kësaj klase asetesh nëpërmjet aksioneve në kompani minerare dhe prodhuese, të cilat mund të kenë një mekanizëm joefikas transmetimi mes vlerës së mallit bazë dhe çmimit të aksioneve, për shkak të kostove operacionale të ndërmarrjes. Mund të investojnë edhe në fondet e tregtueshme elektronike (ETF), të cilat mund ta replikojnë në shkallë të lartë vlerën e mallrave bazë. Disa ETF kolateralizohen në plotni nga mallrat bazë, të tjerë veçse e sintetizojnë vlerën e tyre. Këta të e fundit mund të performojnë me tarifa më të ulëta, por i ekspozojnë investitorët ndaj riskut të kundërpalës të emetuesit të ETF.

Po të ketë qasje në tregjet e kontratave mbi të ardhmen (futures), një investitor mund të jetë drejtpërdrejt i ekspozuar ndaj lëvizjeve të çmimeve të mallrave bazë, pasi ato tregtohen në bursat e mallrave bazë.

Përmbledhja

Inflacioni mund t'i zhvendosë tregjet në mënyrë thelbësore nëse paraqitet me shpejtësi të lartë. Mallrat bazë zakonisht kanë performancë të ulët në një mjedis me inflacion të ulët, por historikisht ato janë dëshmuar se ofrojnë mbrojtje të shkëlqyer ndaj inflacionit të lartë.

Ekuiteti dhe të hyrat fikse me norma variabile janë në gjendje t'i përballojnë presionet e çmimeve nëse inflacioni nuk del nga kontrolli. Ndërkohë që ekuiteti performon kryesisht mirë, me rëndësi kyçe mbetet qasje selektive që përshtatet me perspektivën e inflacionit. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur e shikojmë nga këndvështrimi sektorial.

Në periudha inflacioniste në radhë të parë humbasin kursimtarët, si dhe marrësit e pagesave me normë fikse, si pagat, obligacionet e rregullta dhe qiratë e palidhura me indeks të caktuar. Fituesit janë pozicionet e kundërta, si qeveritë, bankat dhe tregtuesit e borxhit

që paguajnë norma fikse ose pranojnë norma variabile.

Investitorët nuk duhet t'i shmangen pjesëmarrjes aktive në tregjet e kapitalit kur ndodh inflacioni, sepse është një fenomen ciklik dhe me planifikim të kujdesshëm mund të kapërcehen periudha të tilla me performancë të mirë.

Mohim i përgjegjësishë


Në kohën e shkrimit, autori mban pozitë të favorshme në instrumentet e ekuitetit të lidhura me mallrat bazë. Ai nuk merr asnjë kompensim për shkrimin e këtij artikulli.

Mendimet e paraqitura në artikull nuk përfaqësojnë këndvështrimin e botuesit, por vetëm atë të autorit.

Artikulli përmban deklarata në lidhje me të ardhmen.

Ky nuk është rekomandim apo ftesë për investime. Për këshilla rreth investimit ju lutemi kërkoni planifikues financiarë të kualifikuar.

Rising inflation: asset class returns



1 of 3 Avg monthly return in times of rising, but low inflation (<3%) since 1973

2 of 3 Avg monthly return in times of rising & high inflation (3-6%) since 1973

3 of 3 Avg monthly return in times of rising & very high inflation (>6%) since 1973



ARGJIRA KADRIJAJ - DUSHI
UDHËHEQËSE PËR ZHVILLIM BIZNESI
PROCREDIT BANK KOSOVË

Inflacioni dhe efektet e tij tek bizneset e vogla dhe të mesme

Norma e inflacionit dhe lëvizjet e çmimeve sot janë temë kyçe diskutimi dhe vlerësimi për politikëbërësit, bizneset dhe konsumatorët. Inflacioni i tregon konsumatorit se sa më shumë po paguan për mallrat dhe shërbimet që marrim përgjatë një periudhe kohore duke bërë matjen e çmimeve të tyre. Zakonisht, kjo normë i referohet ndryshimit në koston e jetesës në një vend, por në ditët e sotme, norma e inflacionit i referohet kryesisht rritjes së çmimeve të materialeve bazë. Me rritjen e çmimeve, vlera e parasë bie. Kjo e bën më të kushtueshme blerjen e mallrave dhe shërbimeve për konsumatorët.

Rritja e çmimeve në disa sektorë ka filluar gradualisht këtë dekadë për shkak të megatrendeve që kanë ndikuar mbi ekonomi, si globalizimi, ndryshimet demografike, zhvillimi hovshëm teknologjik dhe progresi në digjitalizim. Në dy vitet e fundit, norma e inflacionit po rritet me shpejtësi në nivelet më të larta që nga vitet 80-të. Ky presion në inflacion filloi pas trazirave



SIPAS PYETËSORËVE TË BIZNESIT NË SHBA,

90%

E NVM-VE NGA PANDEMIA E TUTJE I KANË NGRITUR ÇMIMET. EDHE NË KOSOVË NDODH E NJËJTA. NVM-TË PO ANALIZOJNË LËVIZJET E ÇMIMEVE DHE PO I RRSIN ATO SIPAS LËVIZJES SË PRODUKTEVE BAZË NË BURSË. NORMA E INFLACIONIT NË KOSOVË ËSHTË NË NJË MËNYRË E BARTUR, DUKE PASUR PJESËMARRJEN E IMPORTIT MBI

80%

NË BILANCIN TREGTAR.

që pësoi zinxhiri i furnizimit dhe për shkak të rritjes së kërkesës për mallra pas valës së parë të COVID-19. Trendi më i shpejtë i rritjes së inflacionit po vazhdon edhe këtë vit nën ndikimin e sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës, që ka ndikuar në rritjen e çmimit të gazit dhe të naftës. Në raportet e muajit mars në SHBA rezultojnë rritje në indeksin e çmimeve të konsumatorit prej 8.5% nga viti i kaluar, rritje kjo më e larta që nga dhjetori 1981. Në Kosovë, sipas të dhenave të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, në mars 2022 ky indeks ishte 10% më i lartë krahasuar me muajin mars 2021.

Bizneset e vogla dhe të mesme në kohë inflacioni

Bizneset e vogla dhe të mesme (NVM) po i përcjellin nga afër shpenzimet e tyre ndërkohë që norma e inflacionit ka lëvizur, zinxhiri furnizues ka ngecje dhe po ashtu ka çështje të diskutueshme në tregun e punës. Sipas pyetësorëve të biznesit në SHBA, 90% e NVM-ve nga pandemia e tutje i kanë ngritur çmimet.

Sipas **BQK**-së, në tremujorin e parë të vitit 2022, bizneset në Kosovë kanë bërë më shumë se

1,5 miliardë euro

pagesa dalëse të jashtme, shuma më e madhe ndonjëherë e realizuar në krahasim me periudha të njëjta. Depozitat nga ana e bizneseve janë zvogëluar në nivel më të lartë në **10 vitet** e fundit. Po ashtu, financimi për blerje të mallrave është rritur dukshëm, më shumë se financimi në asete fikse.



BUJAR STATOVCI
UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT TË BIZNESIT
BANKA PËR BIZNES

Faktorët kryesor të ndikimit inflacionist në ekonominë e Kosovës

Edhe në Kosovë ndodh e njëjta. NVM-të po analizojnë lëvizjet e çmimeve dhe po i rrisin ato sipas lëvizjes së produkteve bazë në bursë. Norma e inflacionit në Kosovë është në një mënyrë e bartur, duke pasur pjesëmarrjen e importit mbi 80% në bilancin tregtar.

Inflacioni ndikon në rrjedhën e parasë së bizneseve përmes: rritjes së kostos së furnizimeve apo shërbimeve, rritjes së çmimeve të produkteve apo shërbimeve që rrjedh nga rritja e kostos dhe që mund të ndikojë mbi shitjen, duke sjellë si pasojë edhe zvogëlimin e normës së fitimit. Prandaj, NVM-të sot duhet të analizojnë dhe të bëjnë parashikime financiare sistematike në linje me lëvizjet e tregjeve financiare botërore, duhet të automatizojnë proceset dhe t'i digjitalizojnë kanalet e të bërit biznes në mënyrë që të zvogëlojnë kostot e tyre. Mënyra se si bizneset e menaxhojnë aktivitetin e tyre biznesor në këtë kohë inflacioni ka rol vendimtar për vazhdimësinë e biznesit dhe mbijetesën e tyre në treg.

Përkrahja e duhur bankare

Sipas BQK-së, në tremujorin e parë të vitit 2022, bizneset në Kosovë kanë bërë më shumë se 1,5 miliardë euro pagesa dalëse të jashtme, shuma më e madhe ndonjëherë e realizuar në krahasim me periudha të njëjta. Depozitat nga ana e bizneseve janë zvogëluar në nivel më të lartë në 10 vitet e fundit. Po ashtu, financimi për blerje të mallrave është rritur dukshëm, më shumë se financimi në asete fikse. Bizneset, duke ndjekur trendet botërore të lëvizjes së çmimeve dhe problemet në zinxhirin furnizues, kanë bërë blerje në avans. Pra, në këto kohe nevojitet përkrahje në financim nga ana e bankave. Në kohëra të tilla inflacioni, por jo vetën, është me rëndësi që banka të ketë edhe rol këshillues. Në kuadër të strategjisë për të qenë Hausbank – apo banka kryesore e NVM-ve, Banka ProCredit ka përfshirë edhe këshillimin rreth planeve afatshkurtra dhe afatgjata të NVM-ve, përkrahje për t'u njohur me zhvillimet ekonomike botërore dhe vendore në sektorë në vend dhe në rajon dhe po ashtu përkrahjen në gjetjen e partnerëve të biznesit në shtetet

fqinje. Kështu, synimi për të krijuar dhe menaxhuar relacione afatgjata biznesi mes Bankës ProCredit dhe NVM-ve është i nevojshëm në raste të paparashikuara dhe lëvizje të tilla në tregje financiare, në mënyrë që vendimet për financim apo jo, të ndodhin më shpejtë dhe më lehtë.

Në kohëra të tilla priten edhe ndryshime në politikat makroekonomike që ndikojnë direkt tek të bërit biznes të NVM-ve. Një ndër masat që pritet është edhe rritja e normës së interesit nga BQE në tregun evropian, pas rritjes së kësaj norme nga FED në tregun amerikan. Kjo ndikon drejtpërdrejt në menaxhimin e financave dhe investimeve nga ana e bizneseve. Nga ana tjetër, duke qenë se pandemia po shkon drejt fundit, konsumatorët mund të fillojnë të shpenzojnë më pak në mallra dhe produkte dhe më shumë në shërbime. Nëse pushtimi rus në Ukrainë përfundon, çmimet e naftës dhe gazit mund të bien dhe kjo mund të ndikojë në uljen e disa çmimeve të produkteve bazë, edhe pse kjo nuk po duket të jetë afër, duke pasur parasysh zhvillimet e tanishme.

Inflacioni përkufizohet me rritjen e çmimit të përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve që shkakton uljen e fuqisë blerëse. Inflacioni që ka prekur globin, sigurisht se ka pasur ndikim të madh edhe në ekonominë vendore kosovare, ku është raportuar për një rritje të inflacionit që sipas ASK-së e ka arritur 11.2 përqindëshin. Ky trend është vërejtur më shumë në fund të vitit të kaluar, ndërkaq, çmimet janë ende në rritje. Duke pasur parasysh se ekonomia ende po transformohej nga mbyllja e vitit 2020 për shkak të pandemisë, e pastaj rritja e vullshme e vitit pasues, ka rezultuar në krijimin e mos balancave ekonomike të shkaktuar nga shumë faktorë.

Sipas ekonomistëve të shumtë një shkallë e vogël e inflacionit është një shenjë e një ekonomie të shëndetshme, shembull Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të mbajë normën e inflacionit në rreth 2%. Duke filluar nga kuartali i dytë i vitit 2021, në Kosovë ka pasur vazhdimisht rritje të çmimeve gjegjësisht rritje të inflacionit, për të arritur në nivelin prej

SIPAS EKONOMISTËVE TË SHUMTË NJË SHKALLË E VOGËL E INFLACIONIT ËSHTË NJË SHENJË E NJË EKONOMIE TË SHËNDETSHME, SHEMBULL

REZERVA FEDERALE E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

SYNON TË MBAJË NORMËN E INFLACIONIT NË RRETH

2%

DUKE FILLUAR NGA KUARTALI I DYTË I VITIT 2021, NË KOSOVË KA PASUR VAZHDIMISHT RITJE TË ÇMIMEVE GJEGJËSISHT RITJE TË INFLACIONIT, PËR TË ARRITUR NË NIVELIN PREJ

11.2%

NË PRILL TË VITIT 2022 NË RAPORT ME PERIUDHËN E NJËJTË TË VITIT PARAPRAK.

11.2%, në prill të vitit 2022 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Janë disa faktorë kryesorë të cilët kanë ndikuar në rritjen e inflacionit. Fillimisht një ndër faktorët kryesorë që ka shkaktuar rritjen e çmimeve ishte një çrregullim i zinxhirit furnizues si pasojë e rritjes së lartë të kërkesës në krahasim me ofertën pas mbylljes nga pandemia. Rritja e çmimit të naftës dhe gazit konsiderohet si faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e inflacionit. Në këtë kontekst rritja e çmimit të furnizimit dhe importit është derivativë e rritjes së çmimit të naftës dhe gazit. Kjo ka një ndikim signifikant kur dihet raporti i lartë i importit kundrejt eksportit. Faktor tjetër i rëndësishëm i rritjes së inflacionit është invazioni i Rusisë në Ukrainë. Ndonëse jo shumë e ndikuar në mënyrë direkte, në mënyrë indirekte ndikohet nga lufta e Rusisë në Ukrainë.

Si ndikohen bizneset dhe ekonomitë familjare nga inflacioni? Nëse inflacioni është më i lartë në vendet ku bizneset furnizohen ose importojnë sesa në Kosovë, atëherë kjo shkakton



Sipas raportit të Bankës Botërore që është bërë për Ballkanin Perëndimor, inflacioni do të rritet për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimit dhe të energjisë, ndërsa rënia e eksporteve, ndërprerjet në zinxhirët e furnizimeve dhe reduktimi i të ardhurave nga turizmi, pritet të ngadalësojnë rritjen ekonomike.



që mallrat të bëhen më të shtrenjta për bizneset. Rritja e çmimeve të furnizimit shkakton edhe rritjen e kostos, dhe ka efekt në profitabilitetin e bizneseve. Nëse çmimi final i produktit rritet njëjtë në raport me rritjen e çmimeve të furnizimit, atëherë mund të themi se profitabiliteti do të mbetet i njëjtë nëse shitjet nuk bien por, sipas rregullit ekonomik, me rritjen e çmimeve bie edhe kërkesa që nënkupton zvogëlohen shitjet e bizneseve. Për arsye se nëse të ardhurat nominale të familjeve nuk rriten aq sa çmimet, atëherë detyrimisht konsumatorët blejnë më pak që nënkupton se të ardhurat reale bien, e kjo njihet si rënie e fuqisë blerëse.

Sipas raportit të Bankës Botërore që është bërë për Ballkanin Perëndimor, inflacioni do të rritet për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimit dhe të energjisë, ndërsa rënia e eksporteve, ndërprerjet në zinxhirët e furnizimeve dhe reduktimi i të ardhurave nga turizmi, pritet të ngadalësojnë rritjen ekonomike.

“Parashikimet për rritjen e bruto prodhimit të brendshëm në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, gjatë vitit 2022, janë ulur nga 4.1 për qind në

PARASHIKIMET PËR RITJEN
E BRUTO PRODHIMIT TË
BRENDSHËM NË GJASHTË
VENDET E BALLKANIT
PERËNDIMOR, GJATË VITIT
2022, JANË ULUR NGA

4.1%

NË

3.1%

EKONOMITË E

**SHQIPËRISË, BOSNJE E
HERCEGOVINËS, KOSOVËS,
MALIT TË ZI, MAQEDONISË
SË VERIUT DHE SERBISË,**

PAVARËSISHT RIMËKËMBJES
SË KONSIDERUESHME NGA
PANDEMIA E KORONAVIRUSIT,
TANI PO PËRBALLEN ME NJË
SFIDË TË RE, PËR SHKAK TË
PUSHTIMIT TË UKRAINËS NGA
GA RUSIA, THEKSON
KY RAPORT.

3.1 për qind. Ekonomitë e Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, pavarësisht rimëkëmbjes së konsiderueshme nga pandemia e koronavirusit, tani po përballen me një sfidë të re, për shkak të pushtimit të Ukrainës nga Rusia, thekson ky raport.

Banka Qendrore e Kosovës ndërkaq, në raportin e fundit të publikuar thotë se ekonomia e vendit si pasojë e zhvillimeve në Ukrainë, do të pësojë ngadalësim të aktivitetit. Sipas BQK-së, rritja ekonomike do të ngadalësohet në rreth 3.3 për qind këtë vit, nga 10.5 për qind sa ka qenë në vitin 2021.

Ekonomia e Kosovës, e ndikueshme nga faktorët e jashtëm cenohet në vazhdimësi nga zhvillime të tilla globale. Kështu mund të konkludojmë se ndër faktorët kryesor që kanë ndikuar në rritjen e inflacionit janë: çrregullimi i zinxhirit furnizues si pasojë e rritjes së lartë të kërkesës në krahasim me ofertën pas mbylljes nga pandemia, rritja e çmimit të naftës dhe gazit, rritja e furnizimit si derivativë kryesore nga rritja e çmimit të naftës dhe gazit dhe invazioni i Rusisë në Ukrainë.

BURSA STUDENTORE “THE KOSOVO BANKER”



Me rastin e 10 vjetorit të publikimit të revistës ekonomike “The Kosovo Banker” dhe në funksion të nxitjes së hulumtimit mes ekonomistëve të rinj të Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) ka krijuar mundësinë e dhënies së bursës studentore “The Kosovo Banker” për artikullin më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj dhe përfshirjes së artikullit në edicionin e 20-të të revistës “The Kosovo Banker”. Me këtë rast, SHBK ka shpallur konkurs të hapur për bursë studentore të cilën e ka fituar Kastriot Dautaj, student i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” pranë Fakultetit Ekonomik, dega Banka dhe Financa.

Presionet Globale Inflacioniste: Ndikimet në Kosovë dhe rajon

Kastriot Dautaj – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Artikulli fitues i bursës studentore “The Kosovo Banker”

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij artikulli të shkurtër shkencor është të vlerësojë rrethanat e reja të krijuara nga zhvillimet ekonomike aktuale si rezultat i pandemisë Covid-19 dhe situatën e re të krijuar pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Në mënyrë të veçantë, do të fokusohem në rritjen e çmimeve – inflacion për shkak të situatës pas pandemisë Covid 19 si rezultat i mospërputhjes mes ofertës dhe kërkesës, çmimeve më të larta të energjisë dhe inflacionit të shkaktuar si rezultat i pushtimit të Ukrainës nga Rusia, dy eksportuesit kryesorë botërorë të mallrave dhe energjisë.

Aktivitetet ekonomike gjatë viteve 2021/2022 kanë ndryshuar për shkak të rrethanave të reja të krijuara. Kriza të

ndryshme shëndetësore dhe ekonomike kanë ndikuar ndjeshëm në ekonominë globale dhe një nga shkaqet e tyre është pandemia Covid-19. Pandemia përmbysi çdo aspekt të zinxhirëve global të furnizimit, që nga nevojat e klientëve dhe disponueshmëria e materialit e deri te fuqia punëtore dhe aftësitë digjitale. BPV-ja mesatare globale ka rënë për 2.9 për qind nga 2019 në 2020. Ne ende jemi duke u rimëkëmbur nga kriza ekonomike dhe shëndetësore, por po na përcjellin pasiguri të reja.

Lufta në Ukrainë ka shkaktuar çrregullime të mëdha të furnizimit dhe ka çuar në çmime historikisht më të larta për një numër mallrash. Sanksionet evropiane ndaj Ruisë po ashtu kanë rritur çmimet

për produktet themelore si vaji dhe drithërat. Një problem tjetër i ballafaquar ishte rritja e çmimeve të energjisë për shkak të ofertës dhe kërkesës në tregun global të shitjes me shumicë (BBC).

Ndikimi në zinxhirin e furnizimit ndodhi për shkak të kompleksitetit të dukshëm të një zinxhiri tipik global të furnizimit të mallrave të konsumit që përfshin miliona dërgesa dhe mijëra furnizues. Për të adresuar këtë sfidë të re “zotëruesit e zinxhirit të furnizimit” janë duke krijuar zgjidhje të reja nga fillimi deri në fund për të krijuar një zinxhir të ri të furnizimit - një zinxhir që nuk mund të këputet nga ngjarje të tilla të papritura (BBC). / **Artikulli i plotë mund ta gjeni në www.bankassoc-kos.com.**



Ndikimi në zinxhirin e furnizimit ndodhi për shkak të kompleksitetit të dukshëm të një zinxhiri tipik global të furnizimit të mallrave të konsumit që përfshin miliona dërgesa dhe mijëra furnizues. Për të adresuar këtë sfidë të re “zotëruesit e zinxhirit të furnizimit” janë duke krijuar zgjidhje të reja nga fillimi deri në fund për të krijuar një zinxhir të ri të furnizimit - një zinxhir që nuk mund të këputet nga ngjarje të tilla të papritura (BBC).



GENTIANA HALIMI

MENAXHERE E NJËSISË - DEPARTAMENTI PËR INSTITUCIONE FINANCIARE
BANKA KOMBËTARE TREGTARE KOSOVË

Inflacioni si fenomen global i cili ndikon edhe në ekonominë e Kosovës

Presioni global inflacionist, i ardhur nga rritja e çmimeve të mallrave, ka qenë evident në shumë vende që nga fillimi i vitit. Këto vende janë ndeshur me vështirësi nga rritja e shpejtë e çmimeve. Një rritje e tillë krijoi implikime në shumë tregues ekonomikë. Marrë parasysh këto implikime, mirëqenia e klientëve u ndikua drejtpërdrejt. Ka shumë faktorë që kontribuojnë në këtë rritje, siç janë: pushtimi rus i Ukrainës, ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit dhe çmimet e mallrave bazë (energji, nafta etj.). Me efektet e shkaktuara nga inflacioni u vunë re shumë ndryshime në tregun botëror, si: tendenca drejt normave më të larta të interesit, rritja e taksave, ulja e kursimeve etj., kurse mbajtja e një norme të shëndetshme inflacioni në rreth 2 për qind është bërë objektivi shumë i vështirë për t'u arritur.

Në shkurt të këtij viti Rusia pushtoi Ukrainën, duke shkaktuar ndërprerje në zinxhirin e furnizimit botëror. Pas pushtimit, shumë vende filluan të ndejnë presionin e inflacionit, veçanërisht për produktet që eksportoheshin nga këto dy vende.

Teksa lufta vazhdon të intensifikohet, këto efekte janë bërë gjithnjë e më të dukshme. Marrë parasysh që Rusia është një nga eksportuesit më të mëdhenj të derivateve minerale (përfshirë naftën dhe gazin), dhe varësinë e madhe që kanë shumë vende të botës, sanksionet që u vendosën ndaj Ruisë patën një ndikim të madh në mbarë botën. Nga ana tjetër, Ukraina, si eksportues i vajit të lulediellit, misrit, grurit etj., i ndryshon çmimet për këto produkte.

Rajoni ynë, si shumica e vendeve në botë, po përballlet me shumë sfida ekonomike të shkaktuara nga Covid-19 dhe pasojat që vijnë nga lufta e Ruisë

në Ukrainë. Po kështu, vende të tjera në rajon janë duke u përballur me një krizë energjetike e cila lidhet me çmimet e larta të energjisë. Vendet e rajonit që kanë lidhje me Rusinë ishin ato që i ndjenë ndikimet më të rënda. Si rezultat i kombinimit të këtyre faktorëve, rajoni ynë në përgjithësi ka përjetuar rritje të inflacionit. Rritja e çmimeve është reflektuar kryesisht në produktet esenciale si buka, vaji ushqimor, qumështi, vezët etj. Marrë parasysh se shumica e vendeve në rajonin tonë janë vende importi, kjo rritje e çmimeve është “e trashëguar”.

Kosova nga ana tjetër, e ndjeu këtë presion në çmime që vinte kryesisht nga produktet ushqimore, energjia elektrike, derivatet, transporti etj. Presionet globale inflacioniste ishin dukshëm të pranishme edhe në Kosovë, marrë parasysh se vendi i Kosovës është vend importues. Ky trend pritet të vazhdojë gjatë këtij viti. Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Kosova pritet të ketë rritjen më të lartë të BPV-së sipas Raportit të fundit të Bankës Botërore (publikuar në maj 2022).

Ka shumë faktorë që kontribuojnë në rritjen e çmimeve, siç janë:

- Pushtimi rus i Ukrainës,
- Ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit dhe çmimet e mallrave bazë (energji, nafta etj.)



ALBERT DEVAJA
UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT TË PAJTUESHMËRISË
BANKA PËR BIZNES

Instrumentet financiare për ta parandaluar, kontrolluar dhe vonuar ndikimin e inflacionit

Shkaktarët kryesor të inflacionit konsiderohen të jenë rritja ekonomike e një shteti, rritja e furnizimit të tregut me para si pjesë e politikave monetare, rritja e taksave të cilat ndikojnë në rritjen e çmimeve, përkatësisht në rritjen e inflacionit.

Përveç inflacionit të shkaktuar nga faktorët e cekur më lartë, ekziston edhe inflacioni i importuar, i cili shkaktohet nga një sërë faktorësh siç janë: zvogëlimi ose vonimi i prodhimit të produkteve që importohen e që janë esenciale për ekonominë e një vendi, mbyllja e një apo më shumë rrugëve të transportit të mallrave, apo edhe konfliktet në mes të shteteve të ndryshme, të cilat ndikojnë në zvogëlimin e sasisë së prodhimit të këtyre mallrave të cilat importohen në tregjet vendore, duke ndikuar në rritjen e çmimeve të tyre.

Duke qenë se inflacioni importuar dallon nga inflacioni i zakonshëm,

atëherë edhe mjetet të cilat përdoren për të luftuar me këto dy lloje të inflacioneve dallojnë nga njëra tjetra.

Ndër mjetet të cilat parashihen të përdoren për ta parandaluar, kontrolluar apo vonuar ndikimin e inflacionit të zakonshëm janë

Shkaktarët kryesor të inflacionit konsiderohen të jenë:

- 1 Rritja ekonomike e një shteti
- 2 Rritja e furnizimit të tregut me para si pjesë e politikave monetare
- 3 Dhe rritja e taksave të cilat ndikojnë në rritjen e çmimeve, përkatësisht në rritjen e inflacionit.

politikat monetare të një vendi. Në raste të periudhës së inflacionit, qëllimi kryesor i një politike monetare konsiderohet të jetë zvogëlimi i kërkesës për blerje të mallrave, zvogëlim i cili do të ndikonte në uljen e çmimeve të këtyre mallrave, pra do të ulte inflacionin.


Zvogëlimi i kërkesës për blerje të mallrave, bëhet përmes zvogëlimit të sasisë së parave të cilat qarkullojnë në treg, duke ndikuar në uljen e fuqisë blerëse dhe investuese të njerëzve dhe kompanive. Ulja e fuqisë blerëse dhe investuese do të ndikonte në uljen e kërkesës për mallrat e lartpërmendur, e cila do të reflektohej në uljen e çmimeve të këtyre mallrave.

Përdorimi i mekanizmit të lartpërmendur e ka koston e vet, që mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike të një vendi. Për më tepër, ky mekanizëm konsiderohet i suksesshëm në teorinë ekonomike,

Mjetet të cilat mund të përdoren si pjesë e politikave monetare janë:



Kërkesat e institucionit rregullativ bankar për të rritur rezervat e depozitave nga bankat



Ndërhyrja e institucionit rregullativ bankar në ngritjen apo uljen e normës së interesit të kredive apo të depozitave



Kufizimi i shumës totale të kredi dhënies së bankave nga ana e institucionit rregullativ bankar



Blerja apo shitja e valutave të huaja nga ana e institucionit rregullativ bankar (në vendet të cilat përdorin valutë lokale)

por jo gjithmonë funksionon në praktikë sepse ka një numër të konsiderueshëm të faktorëve të jashtëm siç është burimi i ngritjes së inflacionit (nëse inflacioni është ngritur për shkak të faktorëve global, masat e ndërmarra nga një shtet mund të jenë shumë të limituara për ta kontrolluar), apo edhe përcaktimi i kohës së duhur për marrjen e masave të përshkruara më lartë, në të kundërtën këto masa mund të kenë kundër-efekt, që do të thotë se rritja ekonomike ngadalësohet nga masat e ndërmarra, por norma e inflacionit mbetet e njëjta apo edhe rritet më tutje.

Varësisht nga sistemi qeveritar i një vendi, niveli i pavarësisë së institucionit rregullativ bankar të atij vendi si dhe niveli i rregullimit të sektorit bankar nga ana e atij institucioni, mjetet të cilat mund të përdoren si pjesë e politikave monetare janë: kërkesat e institucionit rregullativ bankar për të rritur rezervat e depozitave nga bankat, ndërhyrja e institucionit rregullativ bankar në ngritjen apo uljen

e normës së interesit të kredive apo të depozitave, kufizimi i shumës totale të kredi dhënies së bankave nga ana e institucionit rregullativ bankar, blerja apo shitja e valutave të huaja nga ana e institucionit rregullativ bankar (në vendet të cilat përdorin valutë lokale).

Të gjitha mjetet të cilat u përmendën më lartë përfshijnë vendimet e institucionit rregullativ bankar të një vendi në ndërmarrjen e hapave për ta ulur normën e inflacionit, vendime të cilat jo gjithherë janë të pëlqeshme nga njerëzit e atij vendi, për shkak të efekteve anësore negative që mund të kenë. Po ashtu, institucionet rregullative bankare jo gjithherë e kanë pavarësinë nga qeveria e një vendi, për të ndërmarrë masa parandaluese, kontrolluese apo ngadalësuese në lidhje me rritjen e normës së inflacionit.

Në rastet kur inflacioni është i importuar përmes çmimeve të mallrave dhe produkteve të importuara, masat dhe mjetet të cilat ndërmerren

për parandalimin, kontrollimin apo ngadalësimin e impaktit të tij, konsiderohet të jenë shumë më të kufizuara dhe të pakta. Në këto raste, si mjet për parandalimin, kontrollimin apo ngadalësimin e inflacionit të importuar, mund të përdoren taksat, të cilat aplikohen në mallrat e importuara mund të ulën me qëllim të parandalimit të reflektimit të inflacionit tek mallrat tjera, apo të zvogëlimin të impaktit të këtij inflacioni tek ekonomia e një vendi. Mjet tjetër i cili konsiderohet i rëndësishëm në këtë rast, është subvencionimi i sektorëve të cilët ndikohen nga inflacioni importues, me qëllim të kufizimit të impaktit të inflacionit importues.

Pavarësisht masave dhe mjeteve të përmendura më lartë, duhet theksuar se fuqia ekonomike mbetet faktori kryesor përcaktues në suksesin e një vendi për t'i bërë ballë në mënyrë të suksesshme inflacionit dhe pasojave të tij.



ENEIDA THOMAJ
DREJTORE E PËRGJITHSHME
PAYLINK ALBANIA

Disa nga strategjitë që mund të ndiqen në fushën e pagesave nën ndikimet inflacioniste!

PO, është e vërtetë! Faktorët në të cilat tregu dhe industria e pagesave po përshtatet, vazhdojnë të jenë të paparashikueshme dhe të paprecedent. Këta faktorë patën kryesisht efekte negative, por, nëpër të u vunë re edhe efekte pozitive. Pyetja mbetet çfarë do të ndodh në vijim? Si do të veprojmë në kushtet kur tregu ka presione inflacioniste? Kur çdo bisedë fillon me komentin: **Çmimet janë rritur!?**

Pagesat kanë dhënë zgjidhje edhe më parë për të tillë skenarë, e vazhdojnë të jenë “një dritë jeshile” në këto kohë. Institucionet financiare dhe ato jo financiare, përfshirë këtu dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave, kanë qenë në fokus 2-3 vitet e fundit për shkak të pajtueshmërisë që duhet të kenë me ligjet/rregullorët rishitazi të miratuara e lansuara në treg. Mjafton të shikojmë Shqipërinë dhe Kosovën në hartimin e bazës rregullative mjaft ndihmuese karshi rritjes së konkurrencës në treg, qeverisjes korporative, përfshirjes financiare dhe facilitimit e përdorimit të mjeteve të pagesës, për të kuptuar “barrën” ngarkuar ofruesve të këtyre shërbimeve. Por nga ana tjetër, kjo nuk nënkupton që industria e pagesave të mbetet mbrapa në opsionet

alternative që ofrohen për të optimizuar kanalet e pagesave.

Për sa kohë kërkesa është e tillë!

Në raportin më të fundit të “The Great Payment Transformation” (emarchantpay, 2022), nga 954 tregtarë lider në industrinë e retail, udhëtimeve, linjave ajrore etj., 91% e të vëzhguarve pohojnë se kanë humbje në të ardhura për shkak të zgjidhjes aktuale të

pagesave që kanë të implementuar. Për më tepër, **53% e tyre parashikojnë një rritje në të ardhura me rreth 4-6% në dy vitet në vijim duke implementuar ndryshimet në zgjidhjet e pagesave që ofrojnë.** Ky është një tregues i mjaftueshëm për të nxitur ofrimin e kanaleve alternative. Duhet zgjidhje dhe tregtarët janë të gatshëm të investojnë për këto zgjidhje alternative. Natyrisht pyetja



e radhës që të vjen ndërmend është, po pse kanalet alternative të pagesave po marrin hov tashmë?

Përgjigja më e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë: pasi ulin kostot! E të gjithë i vlerësojmë uljet e kostove. Në tregjet e zhvilluara si Amerikë dhe Angli, rishitazi ka një mbizotërim të “skemave të mbyllura” të ngritura nga tregtarët, ku rreth 45% e FinTech-s dhe ofruesve të pagesave planifikojnë të lansojnë një skemë të mbyllur shoqëruar me një kartë pagese brenda vitit 2022 (PaymentsCards&Mobile, Maj 2022). “Skemat e mbyllura” operojnë nëpërmjet kartave të pagesave, të lëshuara nga një tregtar (në bashkëpunim me një bankë lokale, ku kjo e fundit amortizon kostot e mbajtjes se licencave nga skemat ndërkombëtare të pagesave në këtë format bashkëpunimi) për klientët besnik të tregtarit. Këto karta operojnë në терминаlet pranuese të këtij tregtari (qofshin këto të fundit terminale fizike si POS, apo terminale online) duke bërë që të reduktohen kostot e procesimit të transaksioneve të pagesave pasi tashmë ato kategorizohen si transaksione lokale (duke eliminuar në këtë mënyrë interchange fees). Ky kanal lokal alternativ pagesash, është zhvilluar me gjerë, duke pranuar në një “skemë të mbyllur” **disa tregtarë lokalë.** Këta tregtarë, hyjnë në një marrëveshje ku kartat janë co-brand, dhe pranohen skemat e besnikërisë tek portofoli i klientëve të tregtarëve të pranishëm në skemë. PayLink ka ofruar zgjidhje të tilla në Shqipëri, ku skemat janë ngritur në industri si ato të naftës/gazit, markete apo edhe banka lokale. Për më tepër, PayLink ka ofruar dhe zgjidhje “tërësisht” lokale, duke nënkuptuar këtu që karta brendohet nën skemën PayLink, dhe pranohet në терминаlet lokale në vend, duke funksionuar sipas të njëjtave standardeve PCI të industrisë së pagesave. Të dy opsionet janë të vlefshme në reduktimin e kostos së IRE. Alternativa e parë jep fleksibilitet në përdorimin e kartës edhe jashtë territorit lokal ku karta është lëshuar, ndërkohë alternativa e dytë

është targetuese për atë grup klientësh që operojnë vetëm brenda territorit lokal. Këto alternativa mbeten në gjykim të studimit të sjelljes konsumatore që një institucion ka ndaj portofolit të klientëve të tij.

Thënë sa më lart, këto nevoja të tregut në uljen e kostove, tashmë po orientojnë drejt zgjidhjes “Card-as-a-service”. Institucionet që nuk kanë njohuri të zgjeruar në lansimin apo menaxhimin e kartave, që nuk duan të investojnë në burime njerëzore dhe në infrastrukturë, po mbështeten gjithmonë e më shumë tek procesorët e tyre për të marrë paketa të plota të shërbimeve. Këta të fundit falë bashkëpunimeve që kanë si me skemat ndërkombëtare të pagesave, ashtu dhe me ofrues të tjerë të “nën-zgjidhjeve” të



**RAPORTI MË I FUNDIT
“FUTURE READY PAYMENTS
TECHNOLOGY RESHAPES
THE PLAYING FIELD FOR THE
INDUSTRY” (IDC FINANCIAL
INSIGHTS, JANAR 2022),
POHON SE 74% E PAGESAVE
KONSUMATORE DO TË
REALIZOHET NGA INSTITUCIONE
JO TRADICIONALE FINANCIARE
BRENDA 2030.**

shërbimeve të pagesave, po bashkëpunojnë për të propozuar paketa “standard” që përfshijnë shumë elemente duke përmendur këtu licencimet, zgjidhjet via API, kartat virtuale, skemat e besnikërisë, pajtueshmërinë rregullative, monitorim të portofolit të kartave dhe terminaleve, apo rregullat kundër mashtrimeve etj. Raporti më i fundit “Future Ready Payments Technology Reshapes the Playing Field for the Industry” (IDC Financial Insights, Janar 2022), pohon se 74% e pagesave konsumatore do të realizohet nga institucione jo tradicionale financiare

brenda 2030. Ky vëzhgim konfirmon mundësinë që kanë tregjet si Kosova dhe Shqipëria ku segmentet konsumatore “non-banking” janë mundësi mjaft e mirë për t’u shenjëstruar.

Nga ana tjetër, kjo nuk nënkupton se sektori bankar duhet të mbetet mbrapa në këtë aspekt. Për bankat tashmë paraqitet një vendim për t’u marrë: të ndërtojnë së brendshmi, apo të bashkëpunojnë me palë të treta për funksione shtesë/inovative të kërkuara nga tregu? Në ndihmë për t’iu përgjigjur kësaj pyetje, raporti i fundit nga McKinsey’s Global Banking Annual Review (Dhjetor 2021), rekomandon **inovacion të vazhdueshëm dhe lansim të shpejtë në treg për sektorin bankar** duke dhënë shembuj sukcesi si WeBank (që lansoi deri në 1,000 përditësime në muaj në jo më shumë se 11 ditë nga ideimi i produktit në “go live”), apo NuBank që ka qasje për rritjen e përfshirjes financiare duke dhënë kredi personale për individë të cilët nuk kanë një historik kredie. Pa dhënë më shumë argumente, është e kuptueshme dhe përgjigja e pyetjes shtruar për bankat.

Duke e përmbyllur me një rekomandim të lënë nga “Payments Innovation Jury”, në raportin më të fundit “Innovation by Domestic Payments Systems in the Pandemic” (ECPA, Prill 2021): **“Investimet në inovacionin sistematik është tashmë një detyrim”**, këto kohë do të imponojnë të qënurit në ndryshim të vazhdueshëm e si të tillë bankat apo cilido institucion në fushën e pagesave duhet të implementojë një kulturë të tillë. Ka shumë faktorë që kanë ndikuar në rritjen e pranisë më të madhe të FinTech-s në rajon, si dhe në një performancë më të mirë të tyre në treg (qoftë nga aftësia për t’iu përgjigjur kërkesave specifike të klientit fundor, ashtu edhe nga aftësia për të përfutur nga bashkëpunimet me procesorë, që optimizojnë kostot dhe kohën e hedhjes në treg të produkteve inovative). Në të njëjtin hap do të duhet të ecin edhe institucionet tradicionale të pagesave, në mënyrë që të ruajnë pozicionimin e tyre në treg.

Banka Ekonomike sponsor i Kupës së basketbollit të Republikës së Kosovës

Në kuadër të përgjegjësisë sociale mbështetja e Bankës Ekonomike për sportin ka vazhduar për projekte sportive. Basketbolli është një nga sportet më të popullarizuar i cili ka dhuruar spektakël për shumë vite në elitën e basketbollit.

Së fundi kemi mbështetur organizimin e Kupës së basketbollit të Republikës së Kosovës, me ç' rast në këto gara zhvillohen çerekfinalet e ekipeve femrat super liga, çerekfinalet e ekipeve meshkujt super liga, çerekfinalet e ligës së parë, gjysmëfinalet dhe finalet në tri kategoritë.

Banka Ekonomike do të vazhdoj të ofroj kujdesin institucional për sportin dhe rininë.



Java Ndërkombëtare e Parasë

Banka Ekonomike, me qëllim të shënimit të Javës Ndërkombëtare të Parasë, ka organizuar disa aktivitete vetëdijësuese në shkolla fillore të ndryshme të Kosovës.

E gjithë kjo, me qëllim të edukimit financiar dhe ngritjes së vetëdijes së fëmijëve duke i mësuar se si të kujdesen për paratë, si



të kursejnë dhe rëndësisë së menaxhimit të saj për një të ardhme më të ndritur.

Rëndësia e rritjes së vetëdijes së kursimeve është një nga temat e cila trajtohet për më shumë se një shekull, duke avokuar vazhdimisht, e veçanërisht te gjeneratat e reja.

Kursimet na sigurojnë realizim të ëndrrave, e të ardhme më të sigurtë për të gjitha gjeneratat.




BKT Kosova iu është bashkangjitur iniciativës për mbështetjen e ngritjes së monumentit përkujtimor në nder të profesionistëve shëndetësorë “Për Jetën”

Gjatë viteve, BKT Kosova ka vazhduar mbështetjen e saj në shumë projekte të ndryshme, gjithmonë e angazhuar për ta luajtur një rol edhe më të madh në komunitetin në të cilin vepron. Përkrahja e nismave të ndryshme përmes donacioneve, sponsorizimeve, aktiviteteve vullnetare, e bamirëse, pasqyrojnë vlerat e institucionit për shoqërinë dhe aksionarët e saj.

Është gjithmonë kënaqësi për bankën që të tregoj përkushtimin dhe mbështetjen ndaj përgjegjësisë sociale të korporatës

për shoqërinë. Të kontribuosh për punën dhe sakrificën e punëtorëve shëndetësor është nderë, andaj BKT Kosova iu është bashkangjitur iniciativës për ngritjen e monumentit përkujtimor për kontributin dhe përkushtimin profesional të mantel-bardhëve përgjatë dekadave.

Obelisku u Inaugurua me 16 shkurt para QKUK-së, në ditën e cila u shpall edhe ditë përkujtimore për stafin shëndetësor.



Dita ndërkombëtare e klientit

Për shënimin e ditës ndërkombëtare të klientit dhe për të shpërblyer lojalitetin e tyre, Banka Ekonomike ka shpërblyer me nga një dhuratë modeste klientët të cilët e kanë ditëlindjen sot!

Falënderojmë pafundësisht çdo klient të Bankës Ekonomike për besimin dhe vlerësimin e dhënë.

Donacion për shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Ibrahim Mazreku” të Malishevës



Si pjesë e praktikave të përgjegjshme, BKT Kosova ka përkrahur ndër vite shumë projekte të edukimit, kryesisht përmes donacioneve, duke kontribuar në zhvillimin e arsimit në Republikën e Kosovës.

BKT kësaj radhe ka mbështetur krijimin e Kabinetit Informatik të shkollës fillore të mesme të ulët “Ibrahim Mazreku” e cila është e vetmja shkollë në qytetin e Malishevës, ku numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë shkollë është 900.

Shkolla u pajis me 20 kompjuter, 20 monitorë dhe 2 printerë të cilët do të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve për ndjekjen e zhvillimeve të teknologjisë së informacionit dhe do të lehtësojë punën e të mësuarit.

DSK mbledhë mbi 38 mijë euro nga projekti i mbështetur nga BPB



Down Syndrome Kosova ka arritur të mbledhë 38 mijë e 595 euro nga aktiviteti "Një Kartolinë për Ty", i mbështetur nga BPB. Kartolinat janë shpërndarë në kuadër të 21 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down.

BPB zotohet se në vazhdimësi do të qëndrojë pranë kësaj shoqate, me të cilën tashmë ka të nënshkruar partneritet 5-vjeçar.

BPB punëson disa të rinj të SOS Fshatrave



BPB si partner i SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë ka punësuar disa të rinj nga kjo organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale që është e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë. Këta të rinj janë angazhuar në disa departamente të ndryshme brenda institucionit tonë.

BPB inauguron Akademinë e Burimeve Njerëzore

Banka për Biznes me datë 19 maj duke filluar nga ora 14:00 inauguron Akademinë e Burimeve Njerëzore, në zyrat e këtij institucioni në Prishtinë.

Në këtë ceremoni do të ketë të ftuar nga institucionet bankare në vend dhe partnerët e Bankës për Biznes.

Akademia e Burimeve Njerëzore, është transformuar si e tillë pas pesë vitesh punë intensive që është bërë me programin BPB Junior, që fillimisht kishte nisur si ide për orientimin e studentëve në karrierë si dhe rekrutimin e stafit të ri brenda institucionit.

Studentët e përzgjedhur për këtë program janë trajnuar për tre muaj me radhë nga ekspertët më të mirë të fushës së bankingut dhe jo vetëm, derisa, momentalisht, janë duke u bërë përgatitjet finale për gjeneratën e re të këtij programi, ku kanë aplikuar më shumë se 400 të rinj.



Gati 400 punonjësve të BPB-së, përmes kësaj akademie u mundësohet zhvillimi profesional, duke i njohur me mjedise të reja, pikërisht, përmes moduleve të hartuara nga ekspertët më të mirë të fushës. Me Akademinë e Burimeve Njerëzore, që

veçse po zhvillohet edhe më tutje, sipas kurrikulave të hartuara dhe projeksioneve, BPB është e bindur që e ka përbushur një detyrë të rëndësishme lidhur me avancimin e brendshëm dhe sigurisht si pjesë të saj edhe kuadrot e reja.

Guidë në malet e bukura të Kosovës, BPB nënshkruan partneritet me Klubin Alpin "Prishtina"



Banka për Biznes në bashkëpunim me Klubin Alpin "Prishtina" do të eksplorojë këtë vit disa nga vendet më të bukura të Kosovës, duke sjellë pamje të mrekullueshme nga ekspedita.

BPB ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me Klubin Alpin "Prishtina", që ka në përmbajtjen e saj një sërë të aktiviteteve që kanë të bëjnë me ambientin, kulturën, turizmin, shoqërinë, sportin dhe socializimin. Në guidat që do të organizohen mes dy partnerëve përfshihen paraqitjet e përbashkëta në këto organizime me qëllim të ngritjes së vetëdijes për njohjen e vendit në aspektin natyror dhe kulturor. Nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje e ka bërë zëvendës kryeshefi ekzekutiv i BPB-së, Artan Sadiku dhe përfaqësuesi i Klubit Alpin "Prishtina".

NLB Banka së bashku me FC Prishtina u dhurojnë fanella sportive fëmijëve

Nuk ka asgjë më të çmueshme se buzëqeshja në fytyrat e fëmijëve, andaj me shumë dashuri, sot NLB Banka së bashku me lojtarët e FC Prishtina dhuruan fanella sportive fëmijëve të klasës së VI-të në SHFMU "Dardania".

Përgjegjësia sociale është në qendër të strategjisë së NLB Bankës dhe ne i kushtojmë rëndësi të veçantë mbështetjes së aktiviteteve sportive profesionale dhe për të rinjtë. Në mbështetje të mënyrë tradicionale klubin e futbollit më të vjetër në Kosovë, FC Prishtina, prandaj me lojtarët e këtij ekipi sot organizuam vizitën në SHFMU "Dardania" për t'i gëzuar fëmijët. Takimi i fëmijëve me idolët e tyre sportiv ishte shumë emocionues.



Sporti na bashkon të gjithëve dhe është i rëndësishëm për shëndetin tonë fizik dhe mendor. Ai ka fuqi të bashkojë dhe të ndryshojë botën.

Fëmijë, ju jeni e ardhmja jonë.
Luani, ëndërroni, triumfoni!

Banka ProCredit mbjell 200 pemë në hapësira të ndryshme

Në kuadër të kontributit të vazhdueshëm dhe të aksioneve të tjera që ndërmerr Banka ProCredit për një mjedis sa më të pastër, së fundi është bërë mbjellja e 200 pemëve në tri lokacione të ndryshme në Kosovë. Në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet komunale përkatëse, një pjesë e madhe e këtyre pemëve u mbollën në njërin nga

rrugët kryesore në Prishtinë. Pjesa tjetër u dha si donacion për qytetin e Mitrovicës të cilat u mbollën afër liqenit artificial, duke e bërë atë hapësirë edhe më të këndshme për qytetarët dhe vizitorët. Gjithashtu, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, Banka ProCredit u bë pjesë e projektit të rivitalizimit në fshatin Grashticë.

Shndërrimi i hapësirës nga deponi ilegale në hapësirë të pastër dhe të gjelbër po arrihet përmes pastrimit dhe mbjelljes së pemëve etj. Me aksione të tilla, Banka ProCredit synon të rrisë vetëdijësimin për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit si dhe të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Bëhu mik i natyrës!



TEB dhe BERZH në përkrahje të transformimit digjital të biznesit të Grave

Banka TEB, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për nder të Festës Ndërkombëtare të Gruas, 8 marsit, organizuan eventin “Women Entrepreneurs Embracing Digital Transformation” (Transformimi digjital i bizneseve të Grave).

Pjesëmarrëse në këtë organizim ishin përfaqësues të bizneseve me shumicë pronësie të gruas, të cilat ndër vite kanë bashkëpunuar me bankën TEB dhe BERZH.

Temë kryesore e këtij takimi ishte transformimi digjital i biznesit, si dhe shpalosja e platformave shitjes online, që zhvillojnë më tutje bizneset e tyre. Përfaqësues nga organizatat SheInspires, Appdec dhe UNWOMEN ndanë me



pjesëmarrëset platformat digjitale të krijuara veçanërisht për ndërmarrjet e tyre. Pas prezantimeve, pjesëmarrëset kishin mundësinë të ndjekin njërin nga trajnimet: “Digjitalizimi i

kontabilitetit element me rëndësi për rritje të biznesit” nga Melita& Partners dhe “Rriteni biznesin tuaj me marketingun digjital” nga Think B Agency.



TEB sponsor edhe i Manifesta 14

Banka TEB Sh.A. ka nënshkruar marrëveshje sponsorizimi edhe me organizatorët e Manifesta 14.

Ngjarja më e madhe kulturore në Kosovë për vitin 2022, Manifesta 14 Prishtina do të sponsorohet edhe nga Banka TEB, pas marrëveshjes së arritur ndërmjet dy palëve.

Manifesta konsiderohet si një ndër bienalet më të rëndësishme të artit në Evropë dhe ajo sivjet do të mbahet në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë prej 22 korrikut deri më 30 tetor të këtij viti. Organizimi përmban në vete një program 100 ditor me art, performanca, evente dhe punëtori me qëllimin e fuqizimit qytetar për rikthimin e hapësirave publike në përdorim të sërishëm.

Përgjegjësia sociale korporative është një ndër katër shtyllat kryesore të identitetit të Bankës me shtrirje globale si BNP Paribas, pjesë e së cilës është edhe Banka TEB në Kosovë.

Banka TEB është përkrahëse e shumë aktiviteteve sportive që kanë për qëllim përfaqësimin e vendit, sidomos në partneritet me Federatën e futbollit të

Kosovës, Federatën e basketbollit të Kosovës, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Komitetin paralimpik të Kosovës. Jemi krenar që do të jemi përkrahëse dhe pjesë e bienales evropiane Manifesta, që për herë të parë mbahet në Ballkanin Perëndimor dhe që vendos Kosovën në hartën kulturore evropiane.

Banka TEB është e vetmja në sektorin bankar të Kosovës që ofron program të veçantë për bizneset e grave. Që nga themelimin e këtij programi, janë mbështetur më shumë se 1,500 biznese të femrave me total vlerë të kredive 47 MIO EUR dhe më shumë se 30 trajnime në tema të rëndësishme për mbarëvajtjen e një biznesi.





TEB Bankë për një botë në lëvizje!

Shoqata e Bankave të Kosovës prezanton BRENDA & identitet vizuel të ri!

Në këtë njëzet vjetor të themelimit të Shoqatës së Bankave të Kosovës, me shumë entuziazëm ju prezantojmë brendin e ri të SHBK-së. Inovacionin, Qëndrueshmërinë, Sigurinë dhe Gjithëpërfshirjen janë vetëm disa nga vlerat që simbolizojnë brendin ynë i ri.

LOGO-ja e re e Shoqatës së Bankave të Kosovës është e shënuar me rrethin që përfaqëson monedhën, unitetin, interesat e përbashkëta dhe gjithëpërfshirjen, si dhe tre linjat që përshkojnë përmes dhe përtej rrethit që përfaqësojnë stabilitetin, inovacionin dhe qëndrueshmërinë, të cilat janë vlerat e përfaqësuara edhe nga sektori ynë bankar.

Ngjyrat e freskëta dhe energjike, rrethi dhe linjat kombinohen në një analog të simbolit të Euro që përfaqëson përkushtimin dhe aspiratën e sektorit bankar të Republikës së Kosovës për progres drejt integritimeve evropiane.



Bashkohuni me ne në entuziazmin dhe energjinë tonë të ripërtërirë që sjell brendin ynë i ri!



QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS



INVESTIMI MË I MIRË
ËSHTË NË EDUKIM



PARTNERËT:

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



Qendra për trajnime bankare në kuadër të programit të saj të trajnimeve ofron edhe çertifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.



Kosovo Banking
Association

f #KosovoBankingAssociation

in #KosovoBankingAssociation

Shoqata e Bankave të Kosovës
është anëtare e Rrjetit Evropian për
Trajnime Bankare (EBTN).

<https://www.bankassoc-kos.com/>

